

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7317 E hënë 9 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Intervista** Ditës  
**E**para, mos bëj dëm...”, thoshte Hipokrati. E dyta? Sërish duhej të ishte: mos bëj dëm! Por a është e mundur? Realiteti është shpesh pengues në realizimin...  
*Vijon në faqet 14-15*

Nga ARTA MARKU  
**Mësuesi, jo vetëm i portaleve dhe skupeve televizive**



**Opinion** Ditës  
**M**ë 15 tetor në Maqedoni zhvillohen zgjedhjet lokale, të cilat kanë rëndësinë tyre në aspiratat dhe në strategjinë e popullit shqiptar për të realizuar të drejtat...  
*Vijon në faqen 21*

Nga SHABAN MURATI  
**Shqiptarët nuk duhet të votojnë partitë maqedonase**



Rilind qendra e Vlorës, 11 mln euro investim

## Mblidhet qeveria, Rama: Negociatat me BE, objektivi i 100 ditëve

Kryeministri: Kundërshtarët tanë janë më të rrezikshëm dhe më të egër

Kryeministri Edi Rama mblodhi dje qeverinë duke e publikuar në Komunikimin Javor. Rama u kërkoi ministrave të ndajnë detyrat dhe rolet për secilin prej zv/ministrave, por sipas tij objektivi kryesor i 100 ditëve të para të qeverisjes do të jetë hapja e negociatave për antarësimin në BE. “Objektivi ynë parësor...”

Në faqen 2

## SI MUND TE PERFITONI MARRJEN E KONTRIBUTEVE, TABELAT PER GRATE E BURRAT

# PENSIONI I PLEQERISE, NDRYSHOJNE DOKUMENTET

ISSH: Tre kategoritë dhe lehtësirat që kanë për masën e pagesës. Procedura si do të kryhen veprimet dhe mosha e daljes në pension

Kategoria	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Moshë	Shprehja përqind	Moshë	Shprehja përqind	Moshë	Shprehja përqind
1950	65	100	65	100	65	100
1951	65	100	65	100	65	100
1952	65	100	65	100	65	100
1953	65	100	65	100	65	100
1954	65	100	65	100	65	100
1955	65	100	65	100	65	100
1956	65	100	65	100	65	100
1957	65	100	65	100	65	100
1958	65	100	65	100	65	100
1959	65	100	65	100	65	100
1960	65	100	65	100	65	100
1961	65	100	65	100	65	100
1962	65	100	65	100	65	100
1963	65	100	65	100	65	100
1964	65	100	65	100	65	100
1965	65	100	65	100	65	100
1966	65	100	65	100	65	100
1967	65	100	65	100	65	100
1968	65	100	65	100	65	100
1969	65	100	65	100	65	100
1970	65	100	65	100	65	100
1971	65	100	65	100	65	100
1972	65	100	65	100	65	100
1973	65	100	65	100	65	100
1974	65	100	65	100	65	100
1975	65	100	65	100	65	100
1976	65	100	65	100	65	100
1977	65	100	65	100	65	100
1978	65	100	65	100	65	100
1979	65	100	65	100	65	100
1980	65	100	65	100	65	100
1981	65	100	65	100	65	100
1982	65	100	65	100	65	100
1983	65	100	65	100	65	100
1984	65	100	65	100	65	100
1985	65	100	65	100	65	100
1986	65	100	65	100	65	100
1987	65	100	65	100	65	100
1988	65	100	65	100	65	100
1989	65	100	65	100	65	100
1990	65	100	65	100	65	100
1991	65	100	65	100	65	100
1992	65	100	65	100	65	100
1993	65	100	65	100	65	100
1994	65	100	65	100	65	100
1995	65	100	65	100	65	100
1996	65	100	65	100	65	100
1997	65	100	65	100	65	100
1998	65	100	65	100	65	100
1999	65	100	65	100	65	100
2000	65	100	65	100	65	100
2001	65	100	65	100	65	100
2002	65	100	65	100	65	100
2003	65	100	65	100	65	100
2004	65	100	65	100	65	100
2005	65	100	65	100	65	100
2006	65	100	65	100	65	100
2007	65	100	65	100	65	100
2008	65	100	65	100	65	100
2009	65	100	65	100	65	100
2010	65	100	65	100	65	100
2011	65	100	65	100	65	100
2012	65	100	65	100	65	100
2013	65	100	65	100	65	100
2014	65	100	65	100	65	100
2015	65	100	65	100	65	100
2016	65	100	65	100	65	100
2017	65	100	65	100	65	100

(Në foto) Foto ilustruese. Faksimile e dokumentit të moshës së daljes në pension

**PLAGOSEN DHE 3 VETE**

**Atentat mafioz ndaj shqiptarit në Greqi, dy persona vrasin bashkëpunarin**

Në faqen 6

**DETAJET E POLICISE**

**Zbulohet pedagogu shqiptar që u kap në Malajzi për terrorizëm**

Në faqen 16

**REPORTAZH**

**Romët e egjiptianët që luftojnë me varfërinë e diskriminimin**

Në faqet 12-13

**LISTA E PERDITUSUAR**

**Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës**

Në faqet 17-19

**FLET LEDIAN HALILAJ**



**“Kryeprokurorja më kërcënoi me jetë, më tha: Do të të pres këkën, këmbët e duart!”**

Në faqen 5

Historia e një kolosi. Fatlumë ata që mundën ta shohin në skenë, detajet njerëzore

## Viktor Gjoka, dënimi i aktorit për të dashurën më të re

“Elenën e mora për grua, çfarë bëra ndryshe nga Babë Myslymi?”

Nga RAIMONDA SHUNDI

Artisi i Popullit Viktor Gjoka lindi më 4 korrik të vitit 1922 në Tepelenë dhe vdiq më 26 tetor 2007 në Itali. Aktivitetin artistik e filloi në rininë e tij me lëvizjet amatore. Në vitin 1946 nisi punë në Teatrin Popullor (sot Kombëtar) dhe



punoi deri në vitin 1971. Pa mbushur 20 vjeç realizoi rolet e para ku kujton se sa e pashpresë që përballja me spektatorin. Batuta e vetme nuk mundi të artikulohej dot nga ai edhe pas provave të shumta me idhullin e tij Mihal Popi. Ndër...

Në faqet 10-11

## QEVERISJA MBLEDHJA

Rilind qendra historike e Vlorës, kryeministri: Fatura kushtoi 11 mln euro investim

# Rama-ministrave: Negociatat, objektivi parësor i 100 ditëve

*"Kundërshtarët tanë janë të rrezikshëm dhe të egër"*

Kryeministri Edi Rama mbledhi dje qeverinë duke e publikuar në komunikimin Javor. Rama u kërkoi ministrave të ndajnë detyrat dhe rolet për secilin prej zv/ministrave, por sipas tij objektivi kryesor i 100 ditëve të para të qeverisjes do të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin në BE. "Objektivi ynë parësor, dhe që duhet të marrë mbështetjen e të gjithave ministrave është çelja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE në 100 ditshin e parë të qeverisjes tonë", tha Rama. Duke premtuar reforma në një sërë sektorësh, Rama tregoi kush janë kundërshtarët më të egër të rrezikshëm të qeverisë së tij, duke përfshiruar këtu opozitën. "Na ishte një herë një skuadër që për nga cilësia e individëve u quajtur skuadra e Galaktikave, por Galaktikos nuk fituan asnjë trofe, sepse nuk u bënë kurrë skuadër, frymë në fushën e lojës. Dhe kundërshtarët tanë në fushën tonë, që vetëm lojë nuk është, nuk janë aspak të dobët, përkundrazi janë të egër dhe të rrezikshëm; papunësia, korrupsioni i dhe cinizmi. Kemi edhe një opozitë të dobët që ulërit dhe shan si

ai frikacak që bërtet për të kaluar pyllin natën, por ky është një rrezik më vete për skuadrën tonë, dhe jo lehtësi. Ne kemi vetëm dy aleatë të mëdhenj në këtë betejë aspak të lehtë, popullin, të cilin duhet ta fitojmë përditë me vepër dhe rezultate konkrete dhe dëshirën tonë për ta bërë Shqipërinë që duam me shtet, punë, mirëqenie, një dëshirë që duhet ta ushqejmë përditë duke qenë pranë njerëzve të zakonshëm", tha z.Rama.

### PROJEKTI

Qendra historike e qytetit bregdetar të Vlorës do t'i nënshtrohet një transformimi që do të ruajë arkitekturën ekzistuese të ndërtimeve që datojnë në shekullin e 19-të dhe fillim shekullin e 20-të. Një premtim ky i bërë më herët edhe në fushatë nga Kryeministri Edi Rama, punimet për të cilin nisën si pjesë e një projekti me qeverisë shqiptare dhe Fondit Amerikan të Zhvillimit, që kap vlerën e 11

milione eurove. "Si në të gjitha rastet e tjera, i kemi ndarë dhe detyrat, edhe bërën e përgjegjësisë, goftë për financimin, goftë për koordinimin e të gjitha operacioneve brenda këtij operacioni, sepse këtu bëhet fjalë për një punë që nuk është thjesht ajo që do të bëhet mbi këtë që kemi, por ka të bëjë edhe me gjithë rindërtimin e rrjetit elektrik, ka të bëjë me gjithë rindërtimin e rrjetit të ujësjellësit. Kështu Fondi do

financojë rreth 4 milionë euro, qeveria rreth 7 milionë dhe me një volum të konsiderueshëm, por plotësisht të arsyeshëm, ne do t'i japim gjithë kësaj zone të Vlorës një pamje dhe një përmbajtje tërësisht të re dhe besoj që do t'i krijojmë jo vetëm të gjithë banorëve të zonës, por gjithë komunitetit, një tjetër burim të rëndësishëm zhvillimi ekonomik dhe mirëqenie sociale, përveç se edhe një tjetër arsye për të qenë kërenarë për Vlorën", tha z.Rama.



Kryeministri  
Edi Rama me stafin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Institucioni i Presidencës

### NJOFTIM PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANË KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.93/2017, shpall vendet vakante për pozicionet e **keshilltareve ligjore dhe ekonomike** per institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4)**.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatese, pranë institucionit të KPK-se në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga

institucioni përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: [komisionipavarurikualifikimit@gmail.com](mailto:komisionipavarurikualifikimit@gmail.com); tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) **jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- b) **kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomike) te ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.**



Akuza e kreut të LSI-së: 33 zv/ministrat e Ramës, përfaqësues të oligarkëve

# LSI, Kryemadhi: Bandat drejtojnë Shqipërinë, Rama rrezik kombëtar

"Kriminelët që ke në krah s'të mbrojnë dot"

Valentina Madani

Kryetarja e LSI-së nga Durrësi shpërtheu dje në akuza të ashpra ndaj Kryeministrit Edi Rama duke e konsideruar atë si një rrezik kombëtar. Sipas Kryemadhit Shqipërinë e drejtojnë banditë dhe krimi i organizuar. Një ditë pasi Kryeministri Rama prezantoi emrat e 33 zëvendësministrave që do të mbështesin anëtarët e kabinetit të tij, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi shprehet se kjo provon shprehjen "qeveri e vogël, korrupsion i madh". Sipas Kryemadhit, këta zëvendës/ministra nuk janë socialistë, por përfaqësues të oligarkëve për të mbrojtur interesat e tyre. "33 zv/ministra në qeveri? Rama vërtetoi shprehjen qeveri e vogël, korrupsion i madh. 33 zv/ministrat nuk janë socialistë, por përfaqësues të oligarkëve për të mbrojtur interesat e tyre. Edukata politike në këto 27 vjet, e bazuar te konflikti dhe mohimi dhe kundërshtimi i gjithçkaje. Ne duam të sjellim risi dhe t'i japim fund kësaj tradite. Opozita jonë është e bazuar te alternativa. Ne nuk duam të përfaqësojmë grupe interesi të mafiozeve dhe oligarkëve, por grupe interesi që lidhen vetëm me interesat e drejtpërdrejta të qytetarëve. Edi Rama sulmon njerëzit e thjeshtë, sepse i urren dhe ka neveri për ta", deklaroi zj. Kryemadhi. Deklaratat Kryemadhi i bëri gjatë një takimi me strukturat e LSI në qarkun e Durrësit. Duke analizuar zgjedhjet, Kryemadhi theksoi se LSI zgjodhi të jetë në opozitë për t'u distancuar nga krimi dhe bandat. "LSI përjetoj terrorin më të madh gjatë fushatës, por arriti ndër rezultatet më të mira në Shqipëri. Strukturat e shtetit u bën njësh me bandat dhe krimin e organizuar. Ne zgjodhëm të ishim në opozitë, sepse nuk mund të bëheshim njësh me krimin. Sot Shqipëria drejtohet nga bandat dhe krimi i organizuar. Kemi përballë dy rrugë: të bashkëjetojmë me llumin dhe krimin që po instalon Edi Rama, apo të zgjohemi dhe të sensibilizojmë njerëzit. Edi Rama është jo vetëm rrezik kombëtar, por edhe rajonal", tha Kryemadhi.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

**THIRRJA**  
"Sot Shqipëria drejtohet nga bandat dhe krimi i organizuar. Kemi përballë dy rrugë: të bashkëjetojmë me llumin dhe krimin që po instalon Edi Rama, apo të zgjohemi dhe të sensibilizojmë njerëzit. Edi Rama është jo vetëm rrezik kombëtar, por edhe rajonal", tha Kryemadhi.

## TVSH-ja për biznesin e vogël, reagon LSI

### Vasili-Ramës: Mediokër, marionetë e oligarkisë

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili hodhi akuza të forta drejt Kryeministrit Rama fill pas deklaratave të tij për TVSH që kërkon t'i vendosë biznesit të vogël. Vasili shkruan në "Facebook" se mijëra qytetarë që kanë biznes të vogël dhe mbajnë familjen me të janë në ankth. Sipas Vasilit, biznesi i vogël kërcënohet nga asgjësimi masiv dhe e quan kryeministrin marionetë të oligarkisë. "Kryeministri marionetë e oligarkisë, trembet të flasë për TVSH-në e biznesit të vogël. Mijëra qytetarë, që kanë lidhur mbijetesën e familjeve dhe fëmijëve të tyre me biznesin e vogël, janë në ankth. TVSH për ta është një problem kritik në përballjen e tyre për mbijetesë. Rregullat që kryeministri



i paditur dhe mizor i ndryshon përditë janë një vrasje masive publike. Ky mediokër kryeministër është i qetë vetëm kur oligarkët gëzohen për rregullat që ai vë dhe i pasuron pa fund ata", deklaroi z. Vasili.

#### Reagimi

"Rregullat që kryeministri i paditur dhe mizor i ndryshon përditë janë një vrasje masive publike. Ky mediokër kryeministër është i qetë vetëm kur oligarkët gëzohen për rregullat, që ai vë dhe i pasuron pa fund ata", deklaroi z. Vasili.

garkisë. Mijëra familje lidhen në mëshirë të fatit nga arroganca e një shkollëpaku të shndërruar në marionetë të oligarkisë. Ky kryeministër nepsqar i urren shqiptarët e thjeshtë dhe të varfër. Asgjësimi dhe kthimi i tyre në skllëver e kënaq", deklaroi z. Vasili.



Ish-ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj

## Ish-ministri i PD-së, akuza Ramës

### Demiraj: Krimi terrorizon qytetet, ambasadorët heshtin

Ish-ministri i Brendshëm teknik Dritan Demiraj akuza dje Kryeministrin Edi Rama se krimi po terrorizon vendin duke gjetur mbështetjen e qeverisë. Pas muajsh të tërë qëndrimesh disi neutrale, ish-ministri i PD, që mesa duket është rikthyer në SHBA, shkruan nga Washington DC se Shqipëria është kapur sërisht nga komunizmi, pasi ish-zyrtarë të diktaturës janë rikthyer me bekimin e Ramës. Ky i fundit sipas tij, mban në xhakëtë yjet e Fidel Castros, ndërsa ambasadorët heshtin. "Në një takim për nder të Muajit të Trashëgimisë Latine, Presidenti Trump i përcolli komunitetit Kubanez vendosmërinë e SHBA-se për të luftuar komunizmin dhe mbështetur lirinë dhe demokracinë në Kubë. Shqipëria është e kapur sërisht nga komunizmi. Ish-zyrtarë të lartë të diktaturës komuniste janë rikthyer me bekimin e Edi Ramës dhe drejtojnë shtetin. Edi Rama "mban" yjet e Fidel Castros në xhakëtë dhe u rikujton shqiptarëve bunkerët dhe simbolet traumatizuese të regjimit. Shqiptarët po ikin masivisht si në kohën e ambasadave dhe anijeve fëmëkeqe te vitit 1990. Krimi po terrorizon qytetet si dikur Sigurimi i Shtetit dhe "agjitacion propaganda", shkruan z. Demiraj. Sipas tij: "Dhjetëra- mijëra shqiptarë u burgosën në burgjet komuniste vetëm pse donin lirinë dhe ishin pro-perëndimorë, ndërkohë ambasadorët e shteteve perëndimore heshtin".



#### AKUZA

"Ish-zyrtarë të lartë të diktaturës komuniste janë rikthyer me bekimin e Edi Ramës dhe drejtojnë shtetin. Rama "mban" yjet e Fidel Castros në xhakëtë dhe u rikujton shqiptarëve bunkerët dhe simbolet traumatizuese të regjimit", shkruan z. Demiraj.

rrezik kombëtar, por edhe rajonal", u shpreh kryetarja e LSI-së. Kryemadhi akuza i bëri me tejt: "Kriminelët që Edi Rama ka zgjedhur për t'i pasur në krah nuk kanë për ta mbrojtur dot. Epoka e sundimit të krimin të organizuar do të marrë fund. Më mirë të kesh një infermiere, një këngëtar, një mësues, një shtëpiake, një pensionist dhe një të papunë për ta pasur në krah, se sa një vrasës, një tutor prostitutash, një

trafikan armësh apo trafikant droge, që po drogojnë fëmijët e Shqipërisë. Është më e ndershme të kesh një të papunë shok e mik, të rrishe e të punosh me ta, se sa të jetosh me kriminelët që Edi Rama ka zgjedhur për të drejtuar Shqipërinë". Kryemadhi tha se LSI do të sjellë risi në politikë, pasi ofron një opozitë të bazuar tek alternativat dhe nuk përfaqëson interesat e oligarkëve. "Edukata politike në këto 27

vjet e bazuar te konflikti dhe mohimi dhe kundërshtimi i gjithçkaje. Ne duam të sjellim risi dhe t'i japim fund kësaj tradite. Opozita jonë e bazuar te alternativa. Ne nuk duam të përfaqësojmë grupe interesi të mafiozeve dhe oligarkëve, por grupe interesi që lidhen vetëm me interesat e drejtpërdrejta të qytetarëve. Edi Rama sulmon njerëzit e thjeshtë, sepse i urren dhe ka neveri për ta", deklaroi Kryemadhi.

# MBESHTETJA OPOZITA

Kongresi i forumit rinor, e ftuar Merkel, Këlliçi: Mbështetje kauzës së PD-së

**GARANCIA**

"Z. Ziemiak na garantoi se 'Junge Union' së bashku me fondacionin 'Konrad Adenauer Stiftung' do japin ndihmesën e tyre në adoptimin e praktikave më të mira të rinjve të CDU/CSU, për rritjen dhe fuqizimin e FRPD-së si dhe në funksion të përgatitjes së alternativave dhe një opozite të fortë", - deklaroi z. Këlliçi.

Valentina Madani

CDU/CSU premtom mbështetje, por apelojnë për një opozitë të fortë e konstruktive ndaj një qeverie që ka shkatërruar çdo mundësi për të rinjtë që të ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri. Kreu i FRPD-së, Belind Këlliçi mori pjesë në punimet të Kongresit të "Junge Union", forumit rinor të CDU/CSU në Gjermani, ku është takuar me homologë dhe përfaqësues të organizatave partnere. Në qendër të bisedimeve ishte forcimi i bashkëpunimit dhe më pas situata në Shqipëri. Këlliçi u shpreh se me kreun e komunitetit të të rinjve demokratë në Europë dhe me kreun e unionit ndërkombëtar demokrat të të rinjve në botë, foli për praktikën më negative që qeveria e Edi Ramës ka implementuar me qeverisjen e tij. Këlliçi rrëfeu se ndau me ta shqetësimin për rrezikimin e një eksodi tjetër masiv të shqiptarëve. "Gjatë punimeve të Deutschlandtag 2017, kongresit të 'Junge Union', forumit rinor të CDU/CSU, pata kënaqësinë të takohem me drejtues të forumeve dhe organizatave partnere të FRPD-së. Me kreun e 'Junge Union', Paul Ziemiak diskutuam mbi intensifikimin e bashkëpunimit mes dy forumeve si dhe e falënderova përزمërisht për mbështetjen e pakursyer që i ka ofruar FRPD dhe PD, në mënyrë të veçantë për fjalën e tij në 'Çadrën e Lirisë'. Z.Ziemiak na garantoi se 'Junge Union' së bashku me fondacionin 'Konrad Adenauer Stiftung', do japin ndihmesën e tyre në adoptimin e praktikave më të mira të të

# CDU e Merkel: Opozitë të fortë ndaj qeverisë "Rama"

"Të rinjve në Shqipëri iu shkatërruan mundësitë"



Kreu i FRPD-së, Belind Këlliçi, gjatë punimeve të Kongresit të "Junge Union", forumit rinor të CDU/CSU në Gjermani

rinjve të CDU/CSU, për rritjen dhe fuqizimin e FRPD-së si dhe në funksion të përgatitjes së alternativave dhe një opozitë të fortë e konstruktive ndaj një qeverie që ka shkatërruar çdo mundësi për të rinjtë që të ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri. Gjithashtu pata mundësinë të diskutoj me kryetarin e komunitetit të të rinjve demokratë në Europë (DEMYC), z. Javier Hurtado Mira, dhe me kryetarin e unionit ndërkombëtar demokrat të të rinjve në botë (IYDU), z. Bashir Wardini, për praktikën më negative që

qeveria e Edi Ramës ka implementuar me qeverisjen e tij që nga promovimi i kriminelëve, trafikantëve, mashtruesve, e deri te lehtësirat që u ka krijuar kultivuesve të drogës, që kanë përmblytur vendin dhe Europën me marjuanë 'Made in Albania'. Partnerët tanë u informuan mbi rrezikimin e madh të një eksodi tjetër masiv të shqiptarëve, për shkak të gjendjes së rëndë të kriminalitetit në vend si dhe pas implementimit të rritjes së taksave të parashikuara nga qeveria, e cila do të prekë çdo biznes e çdo familje shqiptare. I garantova ata

se FRPD-ja së bashku me PD-në do të bëjnë një opozitë të fortë dhe pa kompromis kundër qeverisë së lidhur me krimin dhe më të korruptuarën që ka pasur ndonjëherë vendi ynë. 'Deutschlandtag 2017', i cili këtë vit u organizua në Dresden, pati si folës kryesorë ministrin e Brendshëm të Gjermanisë, Dr. Thomas de Maiziere, Sekretarin e Përgjithshëm të CDU, Dr. Peter Tauber, Komisionerin Europian për Buxhetin, z. Günther H. Oettinger, dhe kulmoi me fjalën e Kancelares gjermane, Dr. Angela Merkel.

## ISP thirrje Kuvendit për hetim

### Ndryshojnë vendbanimin, dutetët përfitojnë mijëra euro

Megjithëse kanë apartamentet e tyre në Tiranë, shumë deputetë nuk i deklarojnë ato pranë Kuvendit, me synim që të marrin trajtim financiar për udhëtimin dhe strehimin e tyre. Sipas Institutit të Studimeve Politike, ata përfitojnë nga 500 deri në 1100 euro në muaj. "Pra, përmes deklarimeve formale (certifikata e regjistrimit në zonat elektorale), ata zyrtarisht quhen të pastrehë në Tiranë dhe trajtohen si të tillë, megjithëse posedojnë në Tiranë apartamente, vila apo banesa të tjera private e familjare. Absurd, sipas të cilit me taksat qytetare paguajnë shtrenjtë me çmime hoteli deputetë që flenë në shtëpinë e tyre të dytë/tretë private, meriton vëmendje dhe reagim institucional të menjëhershëm", thuhet në reagim. ISP vlerëson se kemi të bëjmë me spekulim në deklarim dhe shkelje flagrante të ligjit, përvetësim të paligjshëm të pagesave për akomodimin etj., veprë penale për të cilin çdo qytetar tjetër në RSH mund të penalizohet me burgim. Në rastin e deputetëve që kanë bërë deklaratime të tilla, nuk ka pasur hetim dhe nuk ka praktikë aktuale hetimore. Rregullorja e Kuvendit dhe ligji mbi Statusin e Deputetit nuk përcaktojnë mekanizma verifikimi, por marrin të mirëqenë deklarimin e vetë deputetit, duke proceduar direkt me pagesat mujore.



## "I arrestuari, kokë turku për kapobandën"

### Denoncimi i Berishës: Bandat bëjnë ligjin

Ish-kryeministri Sali Berisha i është rikthyer sërish ngjarjes së Elbasanit, duke e cilësuar të arrestuarin si drejtues i "Audit" që goditi policinë, 'kokë turku' të kapobandës Çela. Sipas Berishës, "policia duke mos guxuar të akuzojë Suel Çelën, i cili do të dëshmonte gjithçka për lidhjet e perandorisë së kriminit të Elbasanit me pushtetarë qeveritarë, ndër mori ak-

sionin kundër Bektashit". "Arrestimi i këtij të fundit, - shton Berisha, - është bërë me mirëkuptim, pasi zhdukuri dhe prishi provat e gjetura në makinë, që faktori në mënyrë të pakundërshtueshme se aty në timon ishte vetë Suel Çela dhe se Bektashi është thjesht një ushtar i tij". Po dje, ish-kryeministri publikoi denoncimin e një qytetari nga Kosova që thotë se e kanë sulmuar ndërsa udhëtonte



natën me kamion. Sipas denoncuesit, ai u ka treguar sulmin policëve, por gjithçka ka rënë në vesh të shurdhër. Berisha shprehet se bandat bëjnë ligjin në Rrugën e Kombit, ndërsa policia e ndihmon me sehir.

## "Droga, më rëndë se në Kolumbi"

### Nishani: Në Shqipëri është krijuar mafia

Ish-presidenti Bujar Nishani reagoi dje, pas përplasjes së policisë në Elbasan nga 'Audi' i blinduar. Nishani, në një postim në rrjetin social "Facebook" shkruan se krimi në Shqipëri ka arritur formën më të lartë të organizimit, mafien. Sipas Nishanit, banda e Elbasanit nuk është e vetmja që ka arritur formën e lartë të organizimit kriminal, atë mafioz, pasi banda të tilla ka edhe në Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë e Shkodër. Nishani shprehet se beteja e shtetit me mafien



nuk mund të ketë kthim pas. "Duhet mundur mafia. Beteja me të tani është betejë që nuk mund të ketë kthim pas. Ajo nis e mbaron te pasuritë e paligjshme të saj. Te paratë e pista që lehtësisht sekuestrohen. Veç duhet vullnet politik që të bëhet ajo. Nëse nuk bëhet kjo, atëherë nuk ka luftë kundër mafies", shkruan me tej Bujar Nishani.



I arrestuari, Hektor Psathan

## "Tori i tmerrshëm", që shfrytëzonte prostituta dhe shpërndante kokainë, ish-lojtar i Kombëtares

**DURRËS** - Dy ditë më parë, policia e Durrësit arrestoi një 38-vjeçar, pasi akuzohet për shfrytëzim prostitucioni dhe për shpërndarje kokaine në këtë qytet, kryesisht në zonën e Plazhit. Bëhet fjalë për Hektor Psathan, i njohur ndryshe si "Tori" ose "Psatha i tmerrshëm", pikërisht për shkak të aktivitetit të tij të

jashtëligjshëm që frikëson te jo pak njerëzit që e njihin. Pas vënies në pranga, mësohet se Psatha nuk është një emër i panjohur për durrësakët. Ai ka qenë futbollist i Kombëtares. Bëhet fjalë për futbollin e sallës, pasi ka qenë lojtar i "Teutës" dhe ekipit kombëtar të Shqipërisë. Hektor Psatha madje ka marrë

pjesë në dy kampionate botërore. Ai u arrestua të shtunën, pas një hetimi 6-mujor dhe vëzhgimi të gjatë, ku sipas policisë është vërtetuar se shfrytëzonte femra për prostitucion kundrejt 50 eurove dhe shpërndante kokainë në lokalet e zonës së Plazhit. Për më tepër Psatha rezultoi person me precedent penal të mëparshëm në

fushën e veprave penale kundër pronës. Gjatë operacionit të arrestimit të koduar "Postieri", që u bë pikërisht në ditëlindjen e tij, 38-vjeçarit u gjet edhe një sasi lënde narkotike. Psatha punonte edhe si faturino në urbanë të zonës së Plazhit për të fshehur aktivitetin kriminal.



### Tragjedia, specialistët: Rrezikojnë të shemben gurë të tjerë

**LEZHË** - Ngjarja e rëndë e ndodhur dy ditë më parë në Torovicë të Lezhës ku humbën jetën dy vëllezër dhe bashkëshortja shtazënë e njërit prej tyre, ka qenë një tragjedi e paralajmëruar, pasi prej kohësh rruga që të çon në këtë fshat është degraduar dhe as pushteti qendror dhe as ai vendor nuk i kanë kthyer sytë. Një ditë pas aksidentit tragjik që u mori jetën Edmond dhe Valentin Zefit si dhe 21-vjeçares Alda Gjergji, specialistët të gjeologjisë dhanë alarmin, pasi sipas tyre mund të shemben gurë të tjerë. "Gurë të tjerë rrezikojnë të shemben sërisht. Një banesë është totalisht e rrezikuar. Po bëhet krehja e zonës për të parë situatën dhe mundësinë për të ndërhyrë për shpëtimin e tyre të kontrolluar, me qëllim shmangien e tragjedit si ajo e një dite më parë", - u shprehën ata.

I riu: Pezulloni Rita Gjatit dhe vëreni para drejtësisë. Llalla e emëron në Tropojë

# "Kryeprokuroria më kërcënoi me jetë, më tha: Do të të pres kokën, këmbët e duart"

Ledian Halilaj: Gjithçka nisi pas një statusi në "FB"

### KUKËS

Një 26-vjeçar nga Kukës si dje ka denoncuar publikisht ish-kryeprokuroren e këtij rrethi, Rita Gjati. Bëhet fjalë për Ledian Halilajin, i cili dje bëri me dije se është kërcënuar me jetë nga Gjati, pas një statusi të publikuar nga ai në "Facebook" në korrik të këtij viti. "Mjaftoi një status në rrjetin social 'Facebook' për pafajësinë e babait tim dhe kryeprokurorja Rita Gjati më kërcënoi me jetë në telefon. Më tha: 'Do të të shkatërroj përfundimisht. Mbaje mend çfarë kam me të bo. Do të të pres kokën, duart dhe këmbët'. Menjëherë vura në dijeni kryeprokurorin Llalla, duke i kërkuar urdhër mbrojtjeje dhe hetimin e rastit. Gjithashtu vura në dijeni dhe Ambasadën e SHBA-ve, specifikisht z. Donald Lu. Informova edhe Presidentin e Republikës, kryeministrin dhe shefin e SHISH-it. Ju kërkova hapjen e tabulateve dhe vënien para drejtësisë të kësaj krimineleje sadiste që telefonon dhe kërcënon si xhelate me prerje koke, duarsh dhe këmbësh qytetarë të thjeshtë të papërlayer kurrë me asgjë prej gjëje", - tha Halilaj. Ndërkaq, i riu pohoi se një javë më parë, materiallet në lidhje me këtë kërcënim i janë deleguar prokurorisë së Lezhës, e cila ka nisur hetimet. Nga ana tjetër, burime zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme deklaruan se Rita Gjati, nga drejtuesja e prokurorisë së Kukësit shkon prokurorë e thjeshtë në Tropojë. E kontaktuar nga "GSH", Rita Gjati tha se është në dijeni të këtij vendimi. Ndërsa, në lidhje me denoncimin publik të qytetarit nga Kukësi, ajo u shpreh: "S'kam asgjë për të thënë".



Ledian Halilaj



Ish-kryeprokurorja e Kukësit, Rita Gjati



**NGJARJA**  
Ledian Halilaj pohoi se e ka denoncuar kryeprokuroren e Kukësit për kërcënim që në korrik të këtij viti, ndërsa, dje i kanë hakëruar 3 herë adresën e "FB", duke i fshehur denoncimin publik. "Mezi e riktheva adresën nëpërmjet email-it. Unë kam gjetur numrin e hakeruesit, adresën e email-it si dhe IT. Të dhënat i kam denoncuar në policinë e Kukësit", - tha

26-vjeçari. Sipas tij, gjithçka ka nisur pas një statusi në "Facebook". "Pasi kam publikuar në rrjetin social 'FB' pafajësinë e babait tim të akuzuar nga kryeprokurorja Rita Gjati për kontrabandë në bashkëpunim dhe në mungesë të gjithçkaje që mund të provojë implikimin e tij, 3 magjistratë të Shkodrës dhanë pafajësi për babain tim dhe turnin e tij, pasi kishte detyrë shef turni në

Doganën Morinë. Unë e publikova lajmin e gëzueshëm të miqtë e mi në 'FB', duke cituar dështimin e saj personal dhe institucional duke mos mundur të gjëje asnjë provë, asnjë përgjim, asnjë pamje filmike, siç dhe pretendonte se i kishte, duke zvarritur plot mbi 18 muaj gjyqin e shkallës së parë Kukës. 2 ditë pas publikimit të statusit në wallin tim të 'FB', më ka telefonuar

**LËVIZJET NË PROKURORI**  
Kryeprokurori Adriatik Llalla ka bërë ndryshime mes drejtuesve të Prokurorisë të Kukësit dhe Tropojës, të argumentuara prej tij si lëvizje në kuadër të përmirësimit të punës. Mësohet se ish-drejtuesja e prokurorisë së Kukësit, Rita Gjati shkon prokurorë e thjeshtë në Tropojë. Ndërkaq, Artur Ismailukaj, nga Tropoja shkon drejtues në Prokurorinë e Kukësit. Vendin e tij e zë prokurori Artan Shtrungza.

**MESAZHET**  
0692044...: "Alo, me Ledian Halilaj po flas?  
0697070...: Po.  
0692044...: Rita Gjati në telefon, drejtuesja e prokurorisë së rrethit Kukës. Ti më ke përmendur emrin në rrjete sociale, por unë do të ta pres kokën, duart dhe këmbët, daç me ligj, daç me Kanun. Do të të shkatërroj përfundimisht. Mbaje mend çfarë kam për të bo!

me numrin e saj personal, më është prezantuar si Kryeprokurorja e Rrethit Kukës dhe më ka kërcënuar që i kam përmendur emrin në rrjete sociale", - pohoi 26-vjeçari. Ledian Halilaj kërkon pezullimin nga detyra të Rita Gjatit dhe

vënien e saj në bankën e të akuzuarve. E ndërsa kërkon drejtësi, ai falënderon ambasadën e Shteteve të Bashkuara "në luftën e pakompromis të kësaj fare prokurorësh të padenjë që nuk mund dhe nuk duhet të kalojnë filtrat e vetingut".

### Shoferi i kryebashkiakut Qazim Sejdiu aksidenton të riu

**ELBASAN** - Mesditën e djeshme, shoferi i kryebashkiakut Qazim Sejdiu ka shkakuar një aksident automobilistik në aksin rrugor Librazhd-Elbasan, pranë fshatit Labinot-Fushë. Mësohet se makina tip "Benz" me targa AA 359 NK, e drejtuar nga 51-vjeçari Xh.F., banues në Elbasan, ka përplasur një motoçiklist. Sipas bluve, në momentin e aksidentit në mjetin në fjalë nuk ka qenë kryebashkiaku Sejdiu, por vetëm shoferi i tij. Po të njëjtat burime pohuan, se makina që shkaktoi aksidentin është në pronësi të një kompanie dhe është marrë me qira në përdorim nga Bashkia Elbasan. Personi i plagosur në aksident është 32-vjeçari A.A., banues në Labinot-Fushë. Pas aksidentit, policia deklaroi se drejtuesi i mjetit së bashku me dy të afërm të të dëmtuarit e kanë çuar menjëherë për ndihmë mjekësore në spitalin Kirurgjik Elbasan drejtuesin e motoçikletës, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Policia e Shtetit bën publik planin e masave për mbarevajtjen e ndeshjes së fundit kualifikuese të Botërorit "Rusi 2018", mes Shqipërisë dhe Italisë, e cila do të zhvillohet në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës. Këto masa synojnë garantimin e rendit dhe qetësisë publike para, gjatë dhe pas zhvillimit të ndeshjes, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale,



**Bashkëpunim mes SHISH, AISM, Gardës së Republikës dhe policisë**

**Shqipëri-Itali, masa të forta sigurie për mbarevajtjen e ndeshjes**

kapjen e autorëve të veprave të ndryshme penale dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore. Gjithashtu do të ushtrohet kontroll fizik të të gjithë personave që janë pajisur me biletë para hyrjes në stadium për moslejimin e futjes në stadium të sendeve dhe

materialeve të ndryshme të paligjshme. Policia e Shtetit bën me dije se do të mbikëqyret edhe drejtimi i trafikut rrugor në akset e qytetit të Shkodrës, Tiranë-Shkodër dhe kthim, eskortimin dhe sigurimin e personaliteve të larta shtetërore, të ekipit ko-

mbëtar të futbollit të Italisë dhe Shqipërisë.  
**MASAT ANTITERROR**  
Në kuadër të masave për parandalimin e akteve terroriste, Policia e Shtetit ka marrë një sërë masash me synim studimin, analizimin e të dhënave dhe informacioneve nga specialistët në Drej-

torinë e Antiterrorit. Për këtë, Policia e Shtetit synon bashkëpunimin me SHISH, AISM (Agjencia e Inteljencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes) dhe Gardën e Republikës, por dhe me Policinë e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu, Policia e Shtetit synon edhe monitorimin e faqeve në rrjetet sociale dhe burimet e hapura për identifikimin e individëve dhe grupeve që bëjnë thirrje për nxitjen e fenomenit të ekstremizmit. **in.all.**

Plagosen edhe 3 të tjerë, ende nuk dihen autorët, policia sekuestron kamerat e sigurisë

**Atentat mafioz ndaj shqiptarit në Greqi, dy persona të maskuar vrasin bashkëpronarin e "Joy Bar"**

*Dyshimi, sulmi për larje hesapësh mes bandash në kryeqytet*

Arbër Sulo  
Ina Allkanjari

**GREQI**

Një 37-vjeçar shqiptar ka mbetur i vdekur dhe 3 të tjerë janë plagosur gjatë orëve të para të mëngjesit të djeshëm, në një atentat mafioz në lagjen "Glyfada" të kryeqytetit grek. Sipas policisë greke, rreth orës 04:30 të mëngjesit të së dielës, dy persona të maskuar kanë qëlluar me armë kundër një grupi klientësh që ndodheshin në një prej tavolinave të një lokali në qendër të lagjes rezidenciale të Athinës. Mësohet se ngjarja ka ndodhur jashtë lokalit të njohur të natës "Joy", në kryqëzimin e rrugëve "Metaksa" dhe "Simvulio".

**ATENTATI**

Policia greke bën me dije se dëshmitarët okularë kanë



Vendi ku ndodhi ngjarja



deklaruar se atentatorët janë shtetas shqiptarë. Sipas policisë, dy atentatorët kanë hapur zjarr jashtë lokalit, duke qëlluar në krahorar një nga bashkëpronarët e "Joy Bar", shqip-

tarin 37-vjeçar. Gjithashtu, nga sulmi mafioz është plagosur dhe ndodhet në gjendje kritike për jetën edhe një shqiptar tjetër. Ndërkohë kanë mbetur të plagosur edhe dy shtetas

grekë, 28 dhe 43 vjeç, të cilët mësohet se ishin klientë të lokalit. Viktima dhe tre të plagosurit i transportuan menjëherë drejt spitalit të Asklipio Voulas, ku ndodhen nën

kujdesin e mjekëve, ndërkohë që në vendngjarje mbërriti policia. Forcat policore thanë se, dy atentatorët mundën të largoheshin nga zona me ndihmën e bashkëpunëtorëve të tyre që i prisnin jashtë klubit të natës. Sakaq, ende nuk dihet se kush janë autorët e sulmit mafioz dhe arsyet e kriminit. Sipas burimeve policore dyshohet se atentati lidhet me pistën e larjes së hesapeve mes bandave mafioze që operojnë në kryeqytetin grek. Hetimet janë marrë në dorë nga Departamenti i Sigurisë së Athinës. Policia greke ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale 3 gëzhoja dhe kamerat e sigurisë. Ndërkaq mësohet se 37-vjeçari shqiptar, rezultoi person me precedent penal në fushën e trafikut të drogës, ndërkohë që hetimet janë përqendruar në pistën e larjes së hesapeve.



**Aksident në Kamëz, autobusi i linjës përplas për vdekje të moshuarën**

**HIRANË** - Një person ka humbur jetën, pasi është përplasur mëngjesin e djeshëm nga autobusi i linjës së Kamzës. Rreth orës 08:30, policia është lajmëruar në numrin e emergjencave 112, se një autobus linje tek "Ura e Institutit" në Kamëz ka aksidentuar një këmbësor. Mësohet se viktimja është një grua e moshuar. Në vendngjarje kanë mbërritur menjëherë shërbimet e policisë dhe ambulanca. Mësohet se e moshuara ishte duke kaluar rrugën në momentin kur u aksidentua nga autobusi, ku gjeti vdekjen e menjëhershme. Policia ka ndaluar drejtuesin e automjetit, shtetasin B.C., ndërsa ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BENDER ISD

Centre for Common Ground

Terre des hommes

**CALL FOR PROPOSALS ANNOUNCEMENT**

Terre des hommes (Tdh) in partnership with Institute for Strategic Dialogue (ISD), Center for Common Ground (CCG) and Beder University is implementing the project "Strengthening Civil Society to build youth resilience to Violent Extremism", funded by the European Union. The initiative aims to contribute to ensuring the active participation of civil society in preventing/countering violent extremism through building youth resilience by empowering CSOs working with young people and communities. In this framework a Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is effective **29<sup>th</sup> September 2017-30<sup>th</sup> October 2017**. The overall amount made available under this Call for Proposals is **EUR 201,000**. Tsh Albania aims to award around 25 projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

1<sup>st</sup> category: - **5,000 EURO** (up to 5 projects)  
2<sup>nd</sup> category: **5001-7,500 EURO** (up to 10 projects)  
3<sup>rd</sup> category: **7,501-10,000 EURO** (up to 10 projects)

The deadline for the submission of applications is **30 October 2017 at 17:00**. The application package and related information must be found to the following links: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania>  
[www.cildhub.org](http://www.cildhub.org)  
A copy of the Guidelines and Application package can be additionally requested through sending an email at: [info@tdhalbania.org](mailto:info@tdhalbania.org)

This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BENDER ISD

Centre for Common Ground

Terre des hommes

**THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME**

Terre des hommes (Tdh) në partneritet me Institutin për Dialog Strategjik (ISD), Qendrën për Baza të Përbashkëta (CCG) dhe Universitetin Beder, po zbaton projektin "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Ngritjen e Reziliencës Rinore ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian. Kjo iniciativë synon të kontribuojë në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet ngritjes së reziliencës rinore duke fuqizuar organizatat të cilat punojnë me të rinjtë dhe komunitetin. Në këtë kuadër, Terre des Hommes në Shqipëri, hap një Thirrje për Projekt Propozime nëpërmjet skemës së Sub-Grantimit. Kjo Thirrje për Projekt Propozime do të qëndrojë e hapur gjatë periudhës **29 Shtator - 30 Tetor 2017**.

Totali i shumës për t'u kontraktuar nën këtë Thirrje për Projekt Propozime është **201,000 EURO**

Tdh Albania synon të krontaktojë rreth 25 projekte, të cilat ndahen sipas kategorive të mëposhtme:

Kategoria e parë: - **5,000 EURO** (deri në 5 projekte)  
Kategoria e dytë: **5001- 7,500 EURO** (deri në 10 projekte)  
Kategoria e tretë: **7,501- 10,000 EURO** (deri në 10 projekte)

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është **30 Tetor 2017, ora 17:00**.

Dokumentat e aplikimit dhe informacionin më të detajuar për mënyrën e aplikimit mund të gjeni në adresat e mëposhtme: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania>  
[www.cildhub.org](http://www.cildhub.org)

Një kopje e udhëzimeve për Projekt Propozime dhe dokumentat e aplikimit mund të kërkohen edhe duke dërguar një e-mail në adresën: [info@tdhalbania.org](mailto:info@tdhalbania.org)

**39-vjeçari emër i njohur për policinë, i arrestuar për vrasje në Itali**

**Përndjek ish-të dashurën dhe e mban peng për disa orë, në pranga ish-futbollisti shkodran**

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka arrestuar dje 39-vjeçarin N. Pipa, pasi ka mbajtur peng për disa orë ish-të dashurën e tij, në një banesë në zonën e "Kodrës së Diellit". Denoncimi është bërë nga ish-e dashura e tij, e cila i ka treguar policisë se Pipa e ka përndjekur vazhdimisht. 27-vjeçarja, me profesion ekonomiste, pretendon se ish-i dashuri, ditën e shtunë e ka mbyllur me forcë në një banesë për tri orë, ku ka ushtruar edhe dhunë fizike ndaj saj. Ndërkohë, ish-futbollisti

**DENONCIMI**

Kallëzimi është bërë nga ish-e dashura e tij, e cila i ka treguar policisë se Pipa e ka përndjekur vazhdimisht. 27-vjeçarja, me profesion ekonomiste, pretendon se ish-i dashuri, ditën e shtunë e ka mbyllur me forcë në një banesë për tri orë, ku ka ushtruar edhe dhunë fizike ndaj saj.

shkodran ka pranuar përpara forcave policore se ka debatuar me ish-të dashurën, por ka mohuar ta ketë dhunuar fizikisht. Pas arrestimit, ndaj 39-vjeçarit

N. Pipa janë ngritur akuzat e "Përndjekjes" dhe "Trafikimit të personave të rritur". Ndërkaq mësohet se 39-vjeçari nuk është një emër i panjohur për po-

licinë. Ai është një ish-sportist i Shkodrës që karrierën e vijoi edhe në Itali me skuadrën e San Giovanni-t. Sipas mediave italiane, Pipa rezultoi i arrestuar në vitin 2003 për vrasje, tentativë vrasjeje dhe armëmbajtje pa leje të armëve të ftohta. Ai është arrestuar më 19 tetor të vitit 2003 me urdhër të prokurorit Giacomo Gasperini, për një ngjarje të ndodhur mes natës së 5 dhe 6 tetorit në rrugën "Mbretëresha Elena" në Rimini, ku u sulmuan dy të



39-vjeçari N. Pipa

rinj, njëri prej të cilëve vdiq disa ditë më vonë. N. Pipa u dënua nga shkalla e parë dhe e dytë, por Gjykata e Lartë anuloi dënimin e futbollistit shqiptar, të akuzuar për

vrasje me dashje të 27-vjeçarit Efrain Fernando Carrillo Moscoso, i therur në një stacion autobusi në zonën bregdetare, natën e 5 tetorit 2003. **in.all.**

**Pezullohen nga detyra 3 policë, Ministria e Drejtësisë: Reforma në burgje ka filluar**

**Dhuna ndaj të dënuarit në burgun e Peqinit, prokuroria nis hetimet ndaj 12 zyrtarëve**

*Shkarkohet kryekomisari, procedim disiplinor ndaj drejtorit të IEVP*




**Fier, bie në pranga 33-vjeçari, tentoi t'i jepte 4000 lekë rryshfet policit të Rrugores**

**Fier** - Policia e Fierit ka arrestuar një 33-vjeçar, pasi ka tentuar të korruptonte një prej punonjësve të policisë rrugore. Burime zyrtare nga policia kanë bërë me dije se shtetasi Gazmend Stani, banues në fshatin Mbyet, për të shmangur gobën për shkak të xhamave të zinj që kishte në makinë, ka tentuar t'i japë një rryshfet prej 4000 lekësh punonjësit të policisë. Mbi 33-vjeçarin Stani rëndon vepra penale "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike". Sipas njoftimit të policisë, specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Gazmend Stani, 33 vjeç, banues në fshatin Mbyet, Fier. Mësohet se më datë 07.10.2017, në lagjen "1 Maj" Fier, ky shtetas, duke udhëtuar me mjetin tip "Volkswagen", iu ka dhënë rryshfet 4000 lekë punonjësve të policisë, me qëllim shmangien e masës administrative, pasi kishte makinën me xhama të zinj. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprën penale "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike".

Ina Allkanjari

Nisin hetimet ndaj 12 zyrtarëve në burgun e Peqinit, pas ngjarjes së denoncuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ku një i dënuar pretendoi se ishte dhunuar fizikisht nga grupi i gatshëm i policisë. Ministri i Drejtësisë, menjëherë pasi u vu në dijeni të ngjarjes për dhunën e ushtruar ndaj Viktor Gushit, i cili vuante dënimin për vrasje dhe grabitje bankash, dërgoi në vendngjarje dy grupe për hetimin dhe inspektimin e rastit. Ministria e Drejtësisë bën me dije se provat e mbledhura nga grupi i hetimit të SHKBB-së i janë përcjellë prokurorit të Rrethit Gjyqësor Elbasan. Mësohet se janë marrë masa disiplinore në ngarkim të 12 punonjësve në total. Konkretisht, ndaj 4 punonjësve të IEVP-së Peqin, ndër të cilët 3 punonjës policie dhe 1 staf civil, si dhe për 8 punonjës policie të Forcave Operacionale të Drejtorisë së Policisë së Burgjeve.



Viktor Gushi

IEVP Peqin, rezultoi se punonjësit e policisë të Forcave Operacionale A.I., D.P. dhe A.A. kanë hyrë në qelinë e V.G., pavarësisht se nuk kanë pasur urdhër për kryerjen e kontrollit. Ministria e Drejtësisë sqaron, se pas njoftimit të prokurorit të Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga grupi i hetimit të SHKBB-së, është regjistruar kallëzimi penal dhe është regjistruar procedimi penal në ngarkim të tre punonjësve të policisë A. Ismaili, D. Piku dhe A. Alliu, të cilët dyshohen se janë përfshirë në ushtrimin e dhunës ndaj

të dënuarit V.G. Pas përfundimit të hetimit në datën 7.10.2017, janë shkarkuar nga detyra të tre punonjësit e policisë të sipërpërmendur, të rolit bazë në Sektorin e Forcave Operacionale në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve. Ministria e Drejtësisë bën me dije se, nga verifikimet e bëra, është shkarkuar nga detyra edhe kryekomisari A.Hitaj, me detyrë shef policie, me motivacionin "I papërshtatshëm për të punuar në Policinë e Burgjeve, për shkak të dënimit të tij me vendim gjykatë në vitin 2015 për ve-



prën penale "Shpërdorim detyrë". Ndërkaq, Ministria e Drejtësisë shprehet se distancohet nga ngjarje të tilla, ndërsa në burgje ka filluar reforma, e cila synon largimin e çdo punonjësi me precedent. "Sigurojmë opinionin publik se nuk do të tolerohet asnjë rast dhune apo keqtrajtimi ndaj personave që ndodhen në burgje apo paraburgime, duke vendosur përpara përgjegjësisë penale apo administrative çdo punonjës në sistemin e burgjeve. Reforma në burgje ka filluar, dhe nuk do të lejojmë asnjë punonjës në sta-

fin policor të burgjeve, të cilët janë me precedent penal si dhe shkelin të drejtat e njeriut, të jenë pjesë e sistemit të burgjeve", thuhet në deklaratën e Ministrisë së Drejtësisë. **I DHUARI** I akuzuar për një sërë grabitjesh me armë e dhunë si dhe për vrasjen e një punonjësi të Postës, Viktor Gushi ra në pranga në vitin 2012. Në 2013-ën, Gushi u njoh me masën e sigurisë, ku mori dënimin "burg përjetë". Mësohet se në harkun e 4 viteve, ipandehuri kreu mbi 8 grabitje.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUES GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dë 12.10.2017 ora 16:00'  
Përfundon Ankandit i Dytë për pasuritë:  
- Apartamente sip totale 72 m2, me adres në Rr. "1 Maji" Korçë,  
Me çmim 18 144 Euro  
- Apartament me sip totale 86.03 m2, me adresë në Pogradec  
Me çmim 3 060 000 Lekë  
Ankandit Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Biv.kryesor (ish kinma ilirja),Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHIKIM KOMBËTARË E PËRMBARUES GJYQËSORE PRIVATE SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EKZECUTORËS LITUM" (ECL LIT) sh.p.k.**

Shoqëria Përbartimore "Executores Litum" - sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasuritë e paluajtshme:

1- Pasuria "Trafal" me sip: 2950 m2 + ndërtesa me sip: 2275 m2, e regjistruar në ZVRRP Tiranë në ZK. 2679, me nr. pasurie 5024, vol.35, faqe 58 dhe pasuria "Trafal" me sip: 1050 m2 + ndërtesa me sip: 507 m2, e regjistruar në ZVRRP Tiranë në ZK. 2679, me nr. pasurie 5023, vol.35, faqe 57 e ndodhur në Moxoz, Tiranë, në propozitë të "DISTRIBRANOS" sh.p.k. Çmimi me të cilin do të fitojë ankandit është në vlerën 1.026.648 Euro.

2- Pasuria "Arç" me sip: 1.400 m2, e regjistruar në ZVRRP Tiranë në ZK. 2679, me nr. pasurie 47116, vol.4, faqe 80, në propozitë të "DISTRIBRANOS" sh.p.k. Çmimi me të cilin do të fitojë ankandit është në vlerën 56.448 Euro

Ankandit do të zhvillohet në datë: 12.10.2017 ora 16:00, në zyrën përbartimore "Executores Litum" sh.p.k, me adresë Biv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Në datë 11.10.2017 ne orën 16:00 në zyrën e përbartimit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandit për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit "Njesi" me sipërfaqe totale 87.2 m<sup>2</sup>, numer pasurie 15/231-N1, vol.2014-2016, në zonën kadastrale 8551, me adresë Kavaje.Cmimi në ankand të pare është në vlerën 8,329,553.6 (tete milion e treqind e njezet e nente mijë e pesëqind e tre pike gjashtë) lekë.

INSTAT: Dyfishohet numri i të diplomuarve në profesione të ndryshme

# Arsimi profesional, kërkesat në rritje për 2017, Durrësi kryeson

"Ulet numri i nxënësve për arsimin parauniversitar"


Voltiza Duro

Kërkesalesional kanë pësuar rritje, duke i dhënë prioritet nga viti në vit, e duke mundësuar specializimin e nxënësve në një profesion të caktuar. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, numri i të regjistruarve në shkollat e mesme profesionale për vitin 2016-2017, është rritur ndjeshëm, dhe përbën 19.8% të totalit të të regjistruarve në arsimin e mesëm. Ndërkaq, nëse përllogaritja bëhet vetëm në arsimin publik, kjo përqindje pëson një rritje akoma më të madhe, që shkon deri në 20.9%. Në qarkun e Durrësit, referuar të dhënave, rreth 30% e nxënësve kanë përgjeshur arsimin profesional publik, duke e renditur si qarkun me regjistrimet më të larta në këto shkolla. Ndërkohë, pas tij, renditen qarku i Shkodrës e i Vlorës, me mbi 25% të të regjistruarve në vitin 2016-2017, dhe më tej qarku i Tiranës, me përafërsisht 25% të totalit të nxënësve. Të gjitha qarqet e sipërpërmendura rezultojnë të kenë pësuar rritje në përgjeshjen e shkollave të mesme profesionale kundrejt gjimnazëve të përgjithshme, krahasuar me shifrat e viteve 2012-2013. Ajo çka vlen të theksohet, është fakti që në qarkun e Korçës ka pasur rënie, krahasuar me 5 vite më parë, ku rezultonte në krye të listës me numrin më të lartë të të regjistruarve në shkollat profesionale. Gjithashtu, me ulje paraqiten edhe qarqet Lezhë, Dibër, Kukës e Berat, që nuk arrijnë as shifrën 15% të kërkesave në arsimin profesional.

**TË DIPLOMUARIT**  
Numri i të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale për 2016-ën, pothuajse është dyfishuar krahasuar me vitin 2012, duke arritur nga 7% në 12% në rang vendi. Rreth 87,3% e nxënësve të diplomuar në



Të regjistruar në arsimin profesional publik, 2012-13 dhe 2016-17



19.8

**INSTAT**

Sipas burimeve të INSTAT, theksohet se nxënësit e arimit parauniversitar kanë një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute. Kjo, sipas tyre, i dedikohet kryesisht uljes së lindshmërisë, por edhe faktorit të migrimit.

arsimin e mesëm publik u përkasin gjimnazëve, ndërsa 12,7% e tyre janë diplomuar në arsimin profesional në vitin 2016. Përqindja më e lartë e nxënësve të diplomuar në arsimin e mesëm publik profesional është në qarkun e Korçës, me rreth 35%, ndërsa më e ulëta rezultoi në qarkun e Kukësit dhe të Dibërës, me më pak se 5%

të nxënësve që përfunduan shkollat e mesme. Edhe në qarkun e Gjirokastrës e të Lezhës, të diplomuarit në arsimin profesional rezultojnë me ulje. Ndërsa në Shkodër, Tiranë, Vlorë, Durrës, Elbasan e Berat, numri i nxënësve që morën diplomën në një shkollë profesionale, është rreth 25% për vitin 2016.

**PËR QIND**

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, numri i të regjistruarve në shkollat e mesme profesionale për vitin 2016-2017, është rritur ndjeshëm, dhe përbën 19.8% të totalit të të regjistruarve në arsimin e mesëm. Në qarkun e Durrësit, referuar të dhënave, rreth 30% e nxënësve kanë përgjeshur arsimin profesional publik, duke e renditur si qarkun me regjistrimet më të larta në këto shkolla.

**PUBLIK APO PRIVAT**

Sipas burimeve të INSTAT, theksohet se nxënësit e arimit parauniversitar kanë një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute. Kjo, sipas tyre, i dedikohet kryesisht uljes së lindshmërisë, por edhe faktorit të migrimit. Në arsimin e mesëm publik ndjekin studimet 89,0% e nxënësve të arimit të mesëm në total në shkallë vendi. Në të gjitha qarqet, nxënësit e regjistruar në arsimin publik të mesëm përbëjnë shumicën

krahasuar me regjistrimet në arsimin privat. Ajo çka vihet re në statistikat e INSTAT, është diferenca e ndjeshme mes qarqeve të Shkodrës, Vlorës, Fierit dhe Tiranës, që kanë përqindje më të lartë të arimit të mesëm privat, krahasuar me qarqet e Beratit, Elbasanit dhe Dibërës, ku arsimi privat përbën vetëm një përqindje të vogël ndaj arimit të mesëm gjithsej. Sipas statistikave, në qarkun e Kukësit nuk ka arsim të mesëm privat.

**INSTAT: Tirana, me më pak celebrime në rang vendi**


Ulet numri i martesave me 9.7%, psikologjia: Faktori kryesor, ekonomia e dobët

Numri i martesave në vendin tonë ka ardhur duke u ulur krahasuar me një vit më parë, çka tregon që të rinjtë shqiptarë po tregojnë gjithnjë e më pak interes për këtë event të rëndësishëm të jetës. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, në zyrat e Gjendjes Civile në 2016-ën janë regjistruar rreth 22,6 mijë celebrime martesore, shifra më e ulët e arritur gjatë

këtyre viteve. Celebrimet martesore janë ulur më 9.7% krahasuar me një vit më parë. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", psikologjia Almeida Xhaferi tregon se faktori kryesor që shkakton numrin e ulët të martesave është pasiguria sociale. "Të rinjtë e sotëm kanë pasiguri për të marrë një përgjegjësi kaq të madhe sa martesë, e kjo më tepër për shkak të barrierave për të gjetur një vend pune e për


të siguruar një të ardhme brenda pritshmërive të të rinjve. Martesa së pari kërkon që të përballohen kostot, shpenzimet, të pasurit e një shtëpie, elementë të cilat të rinjtë shqiptarë në ditët e sotme e kanë të vështirë t'i sigurojnë", shpjegon psikologjia. Ajo gjithashtu vendos theksin se një tjetër shkak për mbi numrin në rënie të martesave është dhe shtimi i viteve të studimeve e kualifikimeve. "Sa më i

Numri i martesave gjithsej, 2012-2016



kualifikuar dhe i mirasimuar të jetë një brez, aq më tepër rriten standardet për të kërkuar një jetesë sa më të mirë", - shprehet Xhaferi. Sipas INSTAT, norma bruto e martesës, pra, numri i martesave për mijë banorë tregon se në Shqipëri

regjistrohen 7,7 martesë për mijë banorë në vitin 2016. Vlera më e lartë vërehet në qarkun e Lezhës, me 9,5 martesë për mijë banorë dhe më e ulëta në qarkun e Tiranës, me 6,6 martesë për mijë banorë. **vo.du.**



Veliaj prezanton Tiranën mes 5 rëfimeve njerëzore

Kryebashkiaku Erion Veliaj tregoi transformimin e Tiranës në 2 vitet e fundit dhe vizionin e tij për të ardhmen, nëpërmjet rrëfimit të 5 historive njerëzore. Gjatë eventit "TEDx Prishtina", ku Veliaj ishte i ftuar special, tha se ndryshimet që po ndodhin në Tiranë do të vijojnë me të njëjtin ritëm e se qyteti nuk është thjesht infrastrukturë, por janë njerëzit ata që i japin jetë atij. Kryetari i bashkisë u ndal te një nga investimet që ka ndryshuar një nga zonat më të vjetra të Tiranës, sikurse është Pazari i Ri, e nënvizoi se, pavarësisht se në shumë prej projekteve të realizuara gjithmonë ka pasur debate, në fund të gjithë janë bindur se ndryshimi ka qenë i nevojshëm dhe i duhuri. Por, krahas përmirësimit të infrastrukturës, Tirana ofron edhe një jetë të pasur kulturore, sikurse janë ato që zhvillohen te Reja, për të cilën Veliaj deklaroi se ka gjenuar mbi 170 aktivitete të papërsëritshme. Kreu i bashkisë solli në vëmendje edhe disa prej projekteve më të suksesshme që kanë sjellë një ndryshim të preksihëm në kryeqytet, sikurse janë mbështetja sociale apo përmirësimi i infrastrukturës në komunitet, shkolla e çerdhe, edhe falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm. Ai vlerësoi punën e bërë gjatë këtyre dy viteve për çështjen e strehimit dhe të mbështetjes ndaj shtresave në nevojë. Sipas tij, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë me sukses nismën për hapjen e qendrës së emergjencave si dhe për programin e baneve sociale ku përfitojnë realisht ata që kanë më shumë nevojë. Ndërkaq, Veliaj tregoi edhe historinë e pashoqë të Thanas Dhespos, një ish-idenuar politik, që është një shembull frymëzimi për komunitetin. Ai, së bashku me Nicën, bashkëshorten e tij, vendosën që një pjesë të parave të marra nga vitet e burgut, pas ndryshimit të ligjit në vitin 2014, t'i investonin në të mirë të komunitetit duke rikonstruktuar fasadën e pallatit.





## ARTISTE TE PENALIZUAR CIKLI

Historia e një kolosi. Fatlumë të gjithë ata që kanë mundur ta shohin në skenë, të dëshiruar për ta parë do të ketë gjithmonë

# Viktor Gjoka: Si u dënua aktori për të dashurën më të re se vetja

*"Elenën e mora për grua, ç'bëra ndryshe nga Babë Myslymi?"*

Raimonda Shundi



Artisi i Popullit Viktor Gjoka lindi më 4 korrik të vitit 1922 në Tepelenë dhe vdiq më 26 tetor 2007 në Itali. Aktivitetin artistik e filloi në rininë e tij me lëvizjet amatore. Në vitin 1946 nisi punën në Teatrin Popullor (sot Kombëtar) dhe punoi deri në vitin 1971. Pa mbushur 20 vjeç realizoi rolet e para ku kujton se sa e pashpresë që përbalja me spektatorin. Batuta e vetme nuk mundi të artikulohej dot nga ai edhe pas provave të shumta me idhullin e tij Mihal Popi. Ndër rolet më të suksesshme përmendim Hlietakovin në veprën "Revizori" të Gogolit (1952), "Gratë gazmore të Uindsorit", "Fytyra e dytë", "Karnavalet e Korçës". Pas rreth 13 viteve punë në teatër, në vitin 1959 mundi të marrë një bursë studimi për regjisorë në BS për dy vjet. Me ndërprerjen e marrëdhënieve në vitin 1961 kthehet në Tiranë për t'i vazhduar ato në Konservatorin e Tiranës. Rikthehet në Teatrin Popullor në vitin 1991 me këmbënguljen e drejtorit Artur Zheji, ku vishet me rolin e Spirakes në komedinë rumune "Valsi i Titanikut" (premierën e Iuan Roland Trebicka, Gjoka aktroni në natën e dytë pasi ishte dublat)

dhe më pas me rikthimin e komedisë që i dha suksesin në fillimet e tij në teatër "Revizori", këtë radhë në regjinë e vetë Gjokës.

Filmi artistik ka qenë më pak i lëvruar, por edhe aty kemi një mori personazhesh si të zhanrit të komedisë, ashtu edhe të atij dramatik. Kujtojmë këtu "Kush është vrasësi", "Vdekja e burrit" "Zëvendësi i grave", "Babai i studentit", "Historiani dhe kameleoni". Nga punët në teatër janë të regjistruara vetëm me audio disa nga veprat e vëna dhe ndodhen në arkivat e Radio-televizionit Shqiptar. Kujtojmë "Rrëshqitjen" e Besim Levonjës. Pristanda e Karaxhales, "Një letër e humbur", "Shërbëtorin e dy zotnive" të Karlo Gordonit, "Banjën" e Majakovskit në rolin e Ivan Ivanoviçin e Majakovskit, etj. Në veprën "Majlinda" të Xhemal Brojës, Viktori si i persekutuar pati një rol të vogël, por prezenca e një kritik polak bëri që pena e tij të shkruajë për 'atë infermierin brilant, i cili ngjasonte me Aleksandër Moisiun'. Mundi të marrë titullin "Artisti i Popullit", por nuk e mbrojti dot nga ajo çka do t'i ndodhte. U ndëshkua dhe u dëbua, por shpirti i tij nuk u shkëput asnjëherë nga skena. Dashuria për teatrin dhe spontaniteti i tij si aktor dolën më të forta se burgu i persekutimit artistik dhe njerëzor.

\*\*\*

E njoha Viktorin rreth viteve 80 kur ai po vuante dënimin në Bërzhit. Fshati pranë Tiranës po njihej me historitë e shumta të aktorin i cili po konsumonte artin e tij në aktivitetet modeste të kësaj zone. Në atë kohë ai donte te vinte



Viktor Gjoka

në skenë dramën "Luiza Miler", ndërsa mua më shihte si një alternativë të mundshme. Këtu nisi interesimi im për aktrimin. Kujtoj pasionin dhe detin e thellësisë që transmetonte që në takimet e para. Nuk kisha dëgjuar asgjë deri në atë kohë për bëmat dhe se cili ishte ky burrë simpatik e gazmor për teatrin popullor (kështu quhej për vitet që i referohem). Viktori ishte ashtu siç e kemi parë rrallë në filmat e fundit. Shëndet mesatar, rrumbullak, energjik, fjalëshumë e kureshtar, por me një buzëqeshje që herë herës i qahet kur nisin diskutimet për të shkuarën e tij, duke i lënë vendin trishtimit dhe lotëve.

Jemi mësuar të dëgjojmë për të rinj aktorë të talentuar dhe daljet e tyre rutinë në të gjitha emisionet kulturore (dhe jo vetëm) kur bëhet fjalë për premiera të reja apo profile artistësh. Dëgjojmë kaq shumë për ta në çdo kronikë kulturore, sa që emrat e tjerë sfumohen në heshtjen e arkivave

gojëkyçur. Aktorët si Viktori apo shumë të tjerë janë pa interes (vetëm nëse flitet për vdekjen apo skandalet e tyre). Kjo është koha e konsumizmit të kudogjendur, dhe e "kokoshave majë gardhit", ku i urti shtypet dhunshëm.

I kishin mbetur kaq pak "miq" nga ai kolektiv i rrahur nga pushteti sa diskutonte vetëm kalimthi për shfaqjet e fundit. Kjo bëri që Viktori të mos shkelte shpesh në atë godinë. Shijonte bisedat dhe kënaqësitë e vogla me amatorët apo aspirantët për aktorë. - Jam më i qetë me ta - më thoshte Viktori, "nuk gjykojnë për të shkuarën time, e më shohin me dritë për të ardhmen". Me ta ripërjetonte emocionet e harruara në rrëfimet që nuk i ndaheshin kurrë. E shkuara në teatër, ish gjithçka për të. Mungesa në skenë zëvendësohej me ripërjetimet e copëzave "hit" që i sollën suksesin që ne sot po mundemi të sjellim në vëmendjen e lexuesve tanë. Fliste me pikëllim për mbledhjet e kolektivit, akuzat, apo "miqtë" që fërkonin duart për mundësinë e largimit të aktorit. Sytë i shkëlqenin kur rrëfente copëza nga rolet, ndodhitë me adhuruesit apo bashkëpunimet me regjisorët shqiptarë e Rusë. Por le të kujtojmë çfarë ndodhi me Viktorin e atyre viteve.

### ATMOSFERA NË TEATRIN E VITEVE '60-'70

Në vitet 60-70 teatri ishte strehëza më e preferuar për artdashësit, pasi aktivitetet e kontrolluara e kishin asfiksuar vendin me propagandën pushtetare. Shfaqjet, aktorët, regjisorët, repertori, vëmendja por dhe pakëz nga liria e romantizmit a marrëdhëniet më



normale mund të prekeshin nga spektatorët që çdo natë mbushnin sallën. Biletat e shitura prej javësh nuk plotësonin dot të gjitha kërkesat e qytetarëve fatlumë Tiranës. Aktorët kishin një luftë të heshtur deri në momentin e marrjes apo fitimit të rolit, pasi fluksi i shfaqjeve bënte që shumë të ishin të dubluar. Grupi më i mirë merete premierën, por edhe dublatët kishte fatin të bënin më të mirën e tyre pasi shfaqjet ishin mjaftueshëm. Emrat e njohur të teatrit luftonin shumë për të qenë pjesë e premierës, duke përfutur kështu edhe grupet përkatëse të shfaqjeve në vijim. Por ata nuk ishin në një palë (një pjesë ishte edhe fanatike e pushtetit popullor) me censurën, direktivat partiake apo "pastërtinë morale" duke bërë që shumë heronj të tkurrreshin nga presionet e rrezikshme dhe paktizonin mbijetesën e tyre. Kishin nisur një luftë e heshtur ndaj dy problematikave më të rëndësishme për kohën, "agjitacion e propagandë" dhe "problemet e moralit". Shumë emra aktorësh kërcënoheshin nga "partia" duke vënë në lëvizje mekanizmat e komitetit të partisë, të cilët shihnin në vrimë të gjilpërës çdo aktor sado i dashur për publikun të ish. Në këtë sitë qenë shumë nga emrat e rëndësishëm të teatrit, si Sandër Prosi, Naim Frashëri, Kadri Roshi, por për emrat në veçanti do të flasim në shkrimet në vijim. Ky fat i takoi edhe Viktor Gjokës. ➔

Ishte koha kur magjia e





← artit të shtatë, kinemaja, ish bërë ambicia dhe ëndrra e gjithë trupës së aktorëve. Kishin nisur aventurat e para filmike (filmi "Tana" (58), "Oshëtim në bregdet", "Horizonte të hapura", "Dueli i Heshtur", "Plagë të Vjetra"). Ky zhvillim aktorët i bënte të pavdekshëm në krijimtarinë e tyre, por njëkohësisht mprehte edhe thikat e passhpinës. Gjoka në këtë kohë nuk kishte mundur të filmonte asnjë shfaqje në teatër, pasi ende nuk që kthyer në traditë. Ndërkohë që emri i të riut nga Tepelena kishte nisur të tërhiqte vëmendjen falë përkushtimit, spontanitetit, improvizimit dhe punës me figurën artistike. Kur pjesa e "Revisorit" të Gogolit po vihej në teatër, puna kish nisur me aktorë të tjerë. Por kjo nuk e pengoi Gjokën të merrej "fshehurazi" me provat për figurën e protagonistit, Hljestakovin. Viktori ende nuk pati studiuar për akttrim, ndaj mëdyshja e regjisorit e bënte të punonte vetë. Dhe sukses ishte i pamatë. Këmbëngulja dhe puna e tij mori shpërblimin e ëndërruar. Ky personazh e klasifikoi aktorin e ri automatikisht në qendër të vëmendjes dhe nga këtu, që më i preferuari i regjisorëve, sidomos në zhanrin e komedisë. Spontaniteti, improvizimi, xhongeritimi tipik me figurën e bënë Viktorin mbretin e spektatorit.

Në Shqipërinë e atyre viteve, adhurimi për artistët ishte i vetmi emociion i lirë dhe i pakushtëzuar. Pas shfaqjeve të super suksesshme, Gjoka që ndërkohë ishte lumtur-

ishtë i martuar dhe me fëmijë, gjatë ecjeve në qytet shoqërohej me batutat e roleve apo kërkesat për autografe. Pas kësaj shfaqjeje nisën sukseset e tjera, të cilat u bënë edhe shkolla e shumë aktorëve tanë.

**SKANDALI**

Në këtë kohë nisi të pëshpëritej për "historinë skandaloze" dhe turbulluese - aktori i shquar i teatrit popullor ka lënë shtëpinë, gruan dhe fëmijët dhe ka vënë kurorë me një vajzë gjimnaziste, shoqen e vajzës së tij. Pas kësaj, Viktorin e hodhën në prodhim, duke i privuar edhe të drejtën për të luajtur në teatër. Ai tashmë ishte njëri nga të larguarit në "gjirit e ngrohtë të klasës punëtore". Po atë nuk e la, atë çupëlinën bukurorë, që i ishte ngjitur keqas. Ish 17-vjeç, dhe marrosja e saj verbale me Hljestakovin, Xha Halilin apo Mihallaqin, bëri të flitej gjatë. Ajo, Elena shpërfillëse e një opinioni të frikshëm, mohuese e familjes së saj, e shoqërisë, verbohete për një aktor të madh, por dhe për një burrë gati të të pesëdhjetave, aspak të bukur. Kjo grua e re nuk iu nda në asnjë moment përpos vështirësive, të cilat nuk i mendonte se do i sillte dashuria e tyre. Në një nga intervistat e tij Viktori pohon se "Njeriu bie në dashuri si në një gropë të errët dhe shikon nga të kapet e të dalë përsipër. Por unë mbeta brenë dhe nuk dola dot. Por grua e mora, nuk e mbajta dashnore si shumë të tjerë", madje njëherë provon të shkojë në zyrat e komitetit

të partisë me shpresën se pas kaq viteve mund të kishte shpresë për t'u rikthyer në teatër, ndërsa ai ju përgjigj - "Ah, more Viktor Gjoka, ç'na bëre", Pse na e bëre si lopa more? I dhe një shkëlqim kishte dhe na e derdhe qumështin". "Po unë qumështin e derdha, i thotë Gjoka, por të na rrojë lopa, se lopa bën tjetër qumësht". "Ah, për këto je i zoti ti, por, këtë që bëre... do ta vuash". "Pse kapeni me mua që mora një nuse të re", i thotë Gjoka. "Unë e bëra këtë mëkat. Po Babë Myslymi!...? "Pse, ore, Babë Myslymi je ti?!".

Vendimi për ta larguar nga teatri ishte pas disa mbledhesh me kolektivin. Por a do të mundje aktori të shkëputej nga ai teatër që i dha aq emociione? Flitej se kur binte shi dhe njerëzit mbylleshin në strehëzat e tyre, nga lagja e Tiranës së re nga ku ai banonte, dilte dore për dore një çift duke bredhur rrugëve për t'i mbajtur këmbët nga Teatri Popullor nën pishat e errësirës me një hije trishtimi. Mbanin vesh, njëri shkëputej, tjetri rrinte në këmbë dhe ai që ish shkëputur (Viktori) puthte dyert dhe muret e teatrit, pastaj binte në gjunjë, pëshpëriste dhe bënte kryq. Ishte kjo periudhe kur "armiku" Viktor Gjoka nuk mundte të siguronte as bukë në shtëpi, madje vete ai ka pohuar se shkonte dhe rrëmonte në kazanet e mbuturave kotheret e bukës për t'i pastruar e servitur si ushqimin e ditës. Qarkullonin fjalë se bezdisjet e njerëzve të policisë (80 lekshave) ishin normalitet për netët e tyre, pasi komentëve të turpshme me zë të lartë i bashkohej edhe grushtimi i deryeve shoqëruar me fjalë fyese për të xhitur reagimin e çiftit. Fëmijët shiheshin rrallë, ndërsa gruaja e tij e re, dilte pak dhe kurrë vetëm. Pas kësaj nisi një "rehabilitim" i Gjoka-ve. E shoqja nisi punë si shitëse buke, ndërsa Viktori filloi të aktivizohej tekut me ndonjë film. Kjo ishte edhe koha më e qetë për të projektuar edhe fëmijët e tyre.

**LARGIMI**

Në vitin 1997 largohet në Itali, aty nis gjithçka nga e para. Kampe, përpëlqje, miq të rinj ... deri në momentin kur njihet me konteshën Romane, e cila u robërua nga elektriciteti i aktorit tonë, duke bërë që t'i siguroje strehë atij dhe familjes si shpërblim për artin e bukur. Pas kësaj shkruhet një histori më e qetë për Viktorin. Nis të jetë i lirë me aktivitetet që zhvillonte me emigrantë, krijon shoqatën e artistëve në pension dhe interesohet për teatrin. Realizon filmin artistik "Tirana në Europë" pa humbur në asnjë moment kon-taktin me Shqipërinë. Shoqata



Viktor Gjoka në role



interesohet për teatrin. Realizon filmin artistik "Tirana në Europë" pa humbur në asnjë moment kon-taktin me Shqipërinë. Shoqata

"Dea" i krijoi mundësi të realizonte të pamundurat e së shkuarës, e megjithëse në një moshë jo shumë optimale, ai vazhdoi të dominojë. Interpreti në shqip, italisht, greqisht.

"Jam i sigurt se teatri bën pa mua, por unë nuk bëj dot pa teatrin" - thotë Kadri Roshi dhe po i të njëjtit mendim ishte edhe Viktori. Për të qenë pranë teatrit, ai i pranoi të gjitha sfidat.

**A ISHTE TEATRALI?**

Teatraliteti që kryesisht ndjehej te aktorët në atë periudhë nxitej me shumë edhe nga fakti i ngjitjes së zërit apo mimikës së ekzagjeruar pasi salla e madhe ishte pa akustikë dhe spektatori duhej ndimuar të kuptonte tekstin e veprës. Ndërkohë që aktorët, të cilët po merrshin me filmin po e largonin pak nga pak këtë dukuri. Filmi i mësoi aktorët e kastit, të qenë më të vërtetë dhe më të besueshëm, duke bërë që interpretimi i tyre të ishte më i natyrshtëm. Viktori duke mos e pasur mundësinë e realizimit të asnjë filmi, trezikohej me shumë nga kjo lojë, gjë që e ndëshim pjesërisht në filmat e pakët që mundi të realizonte. Por teksta dëgjohet pjesët e regjistruara shohim se ky interpretim ishte i natyrshtëm për të gjithë trupën e aktorëve.

Viktori nuk e pati shansin t'i filmoheshin shfaqjet, apo t'i organizoheshin diçka speciale në teatrin ku ai u formua dhe la aq shumë, madje nuk ka të mbjellë as edhe një pishë me emrin e tij, siç e kanë një pjesë e kolegëve të teatrit, pasi ishte ende gjallë kur u mbyllën në atë oborr kur orët ishin të pallogaritshme. Megjithatë ne ende flasim për figurat e tij falë asaj çka ka mbërritur nga rrëfimet e kolegëve apo spektatorëve që mundën të prekin lojën e Viktor Gjokës. Shir-itat e regjistruar në radio dhe koleksioni modest i filmimit, vetëm sa mundën të na kujtojnë se dikur ka qenë edhe një aktor, i cili për shkaqe banale, persekutohet dhe i ndalohej ushtrimi i profesionit që donte aq shumë, nga teatri. - Kanë qenë kolegët-aktorë ata që më kanë thënë "Sa bukur e ke luajtur këtë gjë", "Sa bukur ke qëlluar në këtë rol" dhe me një sy kritik të vëmendshëm më kanë treguar detajet e filozofisë sime të aktrimit - thotë Viktori. Nga ana tjetër politika, gjithmonë ka qenë në rivalitet me artistin. Ajo e ka anashkaluar atë, vazhdimisht duke e minuar me mungesën e investimeve për ta. Janë fatlulmë të gjithë ata që kanë mundur ta shohin në skenë, fatkeq ata që nuk kanë mundur ta shohin, dhe të dëshiruar për ta parë do të ketë gjithmonë!



Viktor Gjoka në role



## KOMUNITETET PROJEKTI

Vëzhgimi/ Dy ditë mes njerëzve me ngjyrë në Durrës e Berat

# Romët dhe egjiptianët, komunitetet që luftojnë me varfërinë e diskriminimin

*Si ua ndryshoi jetën projekti i BE e UNDP*

Darina Tanushi

Jemi mësuar t'i shohim gjithmonë pranë kaza nëve të plehrave, duke seleksionuar shishe plastike apo hekurishte për skrap. I shohim edhe në bulevard qdo ditë duke larë me një shishe xhamat e makinave, në këmbim të ndonjë monedhe. Por, është diçka tjetër t'u afroresh, të tentosh të hysh në jetën e tyre. Për dy ditë me radhë me një grup gazetarësh, organizuar nga UNDP më ra rasti të vizitohesh në komunitetin rom dhe egjiptian në Durrës dhe në Berat. Në bazë të projektit FESRE, që mbështetet edhe nga BE, por edhe në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit një pjesë e këtyre dy komuniteteve janë trajnuar dhe punësuar në kompani private apo edhe në shtet. Projekti "Fuqizim Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve - shtysë për përfshirjen sociale" (FESRE) mbështet integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës dhe rritjen e aftësive bazë dhe atyre për jetën, duke synuar aktivizimin e potencialit prodhues të të dy komuniteteve. Ndajesa e parë ishte në një mobilieri në Durrës, por që mbante emrin "Korça". Aty gjetëm të punësuar 4 persona të komunitetit rom nëpërmjet skemës së formimit në punë. Sipas kësaj skeme, të rinjtë e punësuar kanë mundësi të punojnë nën mbikëqyrjen e një mentori gjë që u mundëson përvetësimin e aftësive të nevojshme për punën specifike që ata kryejnë. I pari që na pret është Antonio Avdia, një djalë që nuk i mungon oratoria. "kam bërë një vit gjimnaz", shprehet ai, i gatshëm për të dhënë intervistë. I ati është ndarë nga jeta dhe ai jeton vetëm me nënën e tij dhe vëllain. Antonio tregon se nëna i ka mbajtur duke mbledhur shishe e kanoçe nëpër kazanë. Madje edhe sot që Antonio është në punë, ajo vazhdon



Djemtë romë të punësuar në mobilieri

### STATISTIKA

Censusi i vitit 2011 ka identifikuar 8,300 romë dhe 3,368 egjiptianë, ndërsa vlerësime të tjera identifikojnë 18,276 deri në 120,000 romë dhe mbi 200,000 egjiptianë.

## Alma dhe Enea: Mezi na martuan, na sorollatën në Durrës e Tiranë

Alma dhe Enea është një çift që i gjetëm rastësisht në Qendrën Komunitare Multifunktionale në Nishtulla. Ata sapo kishin lidhur kurorë, madje së bashku me fëmijën e tyre në krahë erdhën të sjellin edhe llokumet e rastit. Enea tregon se më parë kishte lindur fëmija dhe më pas me shumë vështirësi arritën të bëjnë celebrimin dhe kjo e gjitha për shkak të diskriminimit nga ngjyra. "Nusen e kam nga Tirana, vetë jam nga Durrësi. Më thanë shko në Tiranë, pastaj shko në Durrës. Mezi e regjistrua kalamanin. Po shumë e vështirë", shprehet Enea. Me gjithë këmbënguljen tonë, për t'i treguar se ishte shumë e



thjeshtë të bësh një lidhje martesë nëse ke një kartë identiteti. Enea ngulmon se ai është sorollatur në zyrat e gjendjes civile, si në Dur-

rës, ashtu edhe në Tiranë. Këtë e konfirmon edhe avokati i tyre, i cili thotë se ka hasur në shumë pengesa për këtë martesë.

të bëjë të njëjtën gjë. Pronari i mobilierisë shprehet i kënaqur me Antonion, të cilit i ka premtuar që edhe kur të përfundojë projekti do ta mbajë në punë. Sapo dalim nga mobilieria, vajza e qendrës komunitare të Nishtullës, e cila i njëj me saktësi këta banorë të komuni-

titit na tregon edhe nënën e Antonios, e cila ecte me një thes me shishe plastike mbi shpinë. Një grua e sertë që vazhdonë rrugën e saj, pa varësisht syve kureshtarë.

### QENDRA KOMUNITARE

Qendra Komunitare Multifunktionale në Nishtulla,

nën menaxhimin e Bashkisë Durrës u ofron shërbime qytetarëve në këtë rajon, përfshirë romët dhe egjiptianët. Qendra ofron shërbime shtesë në regjistrim civil, duke mbështetur individët të komuniteteve romë dhe egjiptiane, fëmijë, të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë



Gra romë në lagjen "Nishtulla", Durrës

### EDUKIMI

55% e romëve dhe 93% e egjiptianëve (6 deri 9 vjeç) ndjekin shkollën fillore. 96% e vajzave romë dhe 68% e djemve romë (rreth 16 vjeç) braktisin shkollën.

### NISHTULLA



## Lagja e "barakave", drita ekologjike aty ku tuberkulozi mori një jetë

Lagja e "barakave", në Nishtulla është një lagje ku komuniteti rom në Durrës ka prej vitesh strehë e tij. Ka në këtë zonë vila shumë të bukura, por edhe kasolle gjysmë të djegur. Koordinatorja e zonës e projektit Bledina Bushi na tregon se në këtë lagje një grua romë humbi jetën prej tuberkulozit, ndërkohë që 4 banorë të tjerë u infektuan e tashmë janë në ndjekje shëndetësore. Djali i gruas që humbi jetën, na del aty dhe na thotë se nga analizat ai kishte dalë negativ, por jeta mbetet e vështirë. Në këtë lagje, projekti FESRE ka bërë të mundur sistemimin e kanalizimeve dhe ndriçimin e rrugëve me drita ekologjike. Nga ky projekt përfitojnë rreth 940 romë dhe egjiptianë si dhe 19 000 banorë të maxhorancës të zonës së Nishtullës.

bërë regjistrimin civil; mbështetje ligjore për rastet e divorceve; ndihmë ligjore për raste administrative; mbështetje për t'u bërë pjesë e programeve të strehimit; klasa mbështetëse jashtë programit arsimor për fëmijët që vazhdojnë shkollë; mbështetje për plotësim do-

kumentacioni për përfitim e pagesës së aftësisë së kufizuar; shërbime shëndetësore etj. Rreth 421 familje në total kanë akses më të mirë në shërbimet sociale si p.sh. kartat e shëndetit, pagesat e invaliditetit, ndihma ekonomike, banesat sociale, regjistrime etj. Një nga



**TË ARDHURAT**

Të ardhurat për rreth 48% të familjeve rome janë më pak se 10.000 lekë/muaj (rreth 70 euro). Ndërsa 15% e familjeve rome jetojnë në banesa jo të përshtatshme.

**HISTORI**

**Romët në Shqipëri erdhën nga Turqia në shekullin 13-14**

Romët në Shqipëri janë një nëngrup i popullit rom, të cilët njihen dhe emrat ciganë, arixhinj, dhe gabelë, por këto të fundit përdoren dhe në kontekstin negativ. Romët janë vendosur në Shqipëri në shekullin e 13-14, të ardhur nga Turqia e asaj kohe, ku dhe kishin emigruar më parë nga India e veriut. Faktet gjenetike, gjuhësore dhe historike, tregojnë se romët kane emigruar nga India rreth shekullit të 11. Zona nga ata kanë emigruar është India veriore e veriperëndimore e sotme dhe Pakistani lindor i sotëm. Zakonisht romët në Shqipëri flasin gjuhën shqipe, megjithëse dallohen nga theksi apo gramatika e përdorur, dhe në të njëjtën kohë dhe gjuhën e tyre amtare, gjuhën rome. Ka shumë grupe rome që lëvizin shpesh nga një vend në tjetrin nëpër Shqipëri, të cilët nuk flasin shqip, por vetëm gjuhën e tyre rome. Gjuha rome ka ngjashmëri me gjuhët e folura në Indinë e veriut dhe Pakistanin lindor.



njerëzit më të pakënaqur në këtë qendër ishte Vojsava, e cila, siç tregoi kishte kaluar një kalvar të gjatë peripetish për të legalizuar shtëpinë e saj. "Më kërkuan 10 mijë lekë për të më dhënë letrën e legalizimit të shtëpisë", u shpreh ajo. "3 ditë më sorollaten", tha Vojsava

e nxehur, ndërsa punonjëset e qendrës thanë se i kanë ofruar edhe ndihmë juridike asaj dhe të gjithë banorëve që e kanë kërkuar. Një avokat falas, qëndron në qendër për të ndihmuar këtë kategori njerëzish. Por, Vojsava sërish ngulmon: "Na përbuzin nëpër zyra".

Kreu i Bashkisë së qytetit, Petrit Sinaj: Trajtojmë 296 familje rome

# Berat, një grua egjiptiane sekretare në këshillin bashkiak

*Kopështi i ri, në ndërtesën e mbushur me shiringa droge*

Rreth 700 banorë egjiptianë, por 900 familje që etiketohen me termin "maxhorancë" për të mos thënë të bardhë" dërgojnë fëmijët e tyre në të njëjtin kopsht në lagjen "Barrikada", në Berat. Ajo që na bën përshtypje janë kushtet e kopshtit të ri të ndërtuar mbi bazën e projektit FESRE, tejet bashkëkohor dhe që sigurojnë mbarëvajtjen e mesimit për fëmijët e lagjes. Koordinatorët e projektit për Beratin na tregojnë se më parë kjo ndërtesë ishte e mbushur me shiringa, të cilat përdoreheshin nga të rinjtë për të injektuar drogë. Me ndërtimin e kopshtit, jo vetëm janë sistemuar rreth 80 fëmijë, por edhe lagja ka gjetur një lloj qetësie nga ky kontingjent të rinjsh që e përdorte ndërtesën si bazë. Berati megjithatë ka një specifikë ndryshe sa i përket komunitetit egjiptian dhe atij rom. Kryetari i Bashkisë, petrit Sinaj dhe stafi i ngushtë i tij na shpjegojnë se egjiptianët në këtë territor janë më të integruar. "Nuk ka analfabetë egjiptianë, ndërsa romë janë shumë pak", thotë Sinaj. Ndërsa na tregon se sekretarja e këshillit bashkiak në Berat është egjiptiane. Kjo bashki trajnon me ndihmë apo me bonus për strehimin rreth 296 familje. Nënkrjetarja e bashkisë së Beratit tregon edhe një rast që na bën përshtypje. Sipas saj, ka egjiptianë që nuk e deklarojnë që janë të tillë. Ndoshta për t'u ruajtur nga diskriminimi, një pjesë e këtij komuniteti preferon të fshehë identitetin e tij.

**TURIZMI**

Qyteti i "një mbi një dritareve", megjithatë ka mjaft probleme, me kanalizimet apo ujën e pijshëm, për të cilat kryetari i Bashkisë Sinaj thotë se shumë shpejt do të ketë zgjidhje. I pyetur në lidhje me shifrat e turizmit, Sinaj shprehet se në vit në Berat shkojnë mbi 60 mijë turistë, një shifër kjo rreth 35% më e lartë se një vit më parë. Një lajm i mirë që vjen nga bashkia e Beratit për të gjithë ata qytetarë që përdorin bujtinat e tyre për turizmin është se po mendohet që



Kopështi në lagjen "Barrikada", Berat

## Manjola Lushi: E divorcuar nga burri, me vështirësi po rris 3 fëmijët

Manjola Lushi është nënë e tre fëmijëve. Ajo është e ndarë nga bashkëshorti dhe me shumë përpjekje po mundohet të rrisë, të ushqejë dhe edukojë fëmijët e saj. Në momentin e parë kur e takojmë duket një vajzë e pastër, e kuruar sigurisht me aq mundësi sa ka. Nuk pranon t'i bëjmë një foto, ku të shfaqet portreti i saj i plotë. Ata që e njohin, në vendin e saj të ri të punës si sanitare, që e ka përfutur falë projektit FESRE, me shkollën jobpublike "Ngjeçari" në Berat, na tregojnë se Manjola ka ndërtuar një tip kasolle në oborrin e shtëpisë së të atit të saj dhe mezi siguron fëmijët, pas ndarjes me bashkëshortin. Në intervistë ajo na tregon se edhe falë kësaj pune, e ka shumë të vështirë të sigurojë të ardhurat.

**Më flisni pak për jetën tuaj?**

Quhem Manjola Al-lushi. Jam e ndarë nga im shoq. Kam 3 fëmijë, jetoj në kushte shumë të vështira. Po vuaja për të gjetur një punë. Rastë-



Manjola Lushi

sisht qëlloi që u njoha me këtë projekt dhe më ndihmuan.

**Si ishte jeta jote para se të fillojë këtë punë?**

Ishte shumë e vështirë, jashtë mase. Nuk ia del dot të kesh 3 fëmijë, të jesh e vetme. Vetëm kur gjeja ndonjë punë atje shkoja punoja. Strehë nuk kam.

**A kenë siguruar tani**

Rama, pasi tashmë i përkasin dy partive të ndryshme, Sinaj shprehet qartë: "Nuk besoj se investimet varen nga humori i kryeministrit

**strehë?**

Jo, nuk kam akoma, sepse edhe nuk ia dal dot me qira. Jetoj në një si tip kasolle që e kam rregulluar bashkë me fëmijët e mi. Jam e kënaqur nga puna

**Paguheni mirë?**

Siguroj diçka për bukë. Fëmijët i kam në shkollë. Shumë me të keq ia dal.

t'u hiqet taksa që ata paguan për shtretër. I pyetur në lidhje me marrëdhëniet që ka me qeverinë e re dhe Kryeministrin Edi

apo kryetarit të bashkisë". Ai tregon se Bashkia ka aplikuar për financime me projekte dhe pret që t'i marrë ato nga qeveria.

## INTERVISTA

# Nën dritën e zbehtë të tryezës së shkrimit (kur fiket projektori i sallës operatore)

Nga Arta MARKU

**E** para, mos bëj dëm...”, thoshte Hipokrati. E dyta? Sërisht duhej të ishte: mos bëj dëm! Por a është e mundur? Realiteti është shpesh pengues në realizimin e këtij qëllimi të mirë... “Edhe zogjtë bëjnë gabime... – thoshte poeti – e të ecësh në tokë është më e vështirë se të fluturosh në ajër...” Akoma më tepër, të ecësh në tehu e një brisiku a mbi një tel të tendosur prej nga, tekta hedh shikimin poshtë, vëren se lartësia është vrasare.

\*\*\*

Cili je ti korridoreve të një spitali? Me shumë gjasë jo ndjekësi i një historie sado tronditëse që të magnetizon para një ekrani. Protagonist, për më tepër, jo në rolin e tjetërkujt, por të vetvetes. “Subjekti” është diçka me të cilin do të njihesh hap pas hapi, se nuk mund ta dish që në krye të herës. I pakrahueshëm me makthin e një romani që nuk ia di fundin. Atëherë frika... e vetmja ndjenjë e pastër, e kultuar dhe e qashtë, që fisnikëria i buron nga zorrët e barkut, të tretet në gjak e ti nuk e manipulon dot. Moirat enden rreth e rrotull si prani e fuqishme, sado të padukshme nga syri. Çfarë kanë vendosur për ty? Pyetja shkakton një dhimbje të padurueshme që nuk mund të lokalizohet. *Angor animi!* Pse unë? A mund të shmangem dëmi? Sa pyetje nuk marrin përgjigje... të paktën jo korridoreve të akullta të një spitali. Përballë teje, në do të bardha verbuese, ata që do të donin të mos bëjnë dëm.

\*\*\*

“Mos bëj dëm”, thotë neurokirurgu britanik Henry Marsh. Por, a është e mundur? Realiteti mund të jetë pengues në realizimin e qëllimit të tij të mirë. Moirat aty, mbi të, duke vigiliuar për t’u siguruar se vendimi i tyre për ta “bërë atë dëm”, nëse kanë vendosur kështu, do të respektohet...

“Mos bëj dëm”, është i mendimit edhe neurokirurgu shqiptar Mentor Petrela. Me uniformën e sallës operatore, duart me doreza sterile llastiku, nën prozhektorin e fuqishëm të sallës operatore, ngjashëm me Henry Marshin, qëllim-it për të mos bërë dëm kërkon t’i përmbahet... Por realiteti, i sëmurë, moirat... ecja mbi një tel të tendosur...

Në fakt, më së shumti, **nuk bëhet dëm**.

\*\*\*

“Mos bëj dëm” është titulli i librit të Henry Marshit që ka mbërritur në shqip, i përkthyer nga Mentor Petrela në bashkëpunim me Florian Dashin. E te libri dua të qëndrojme, në një bisedë me neurokirurgun shqiptar... për dëmet që bëhen e nuk bëhen por edhe për të tjera.

**- Bisedoja me miq tekta lexoja librin “Mos bëj dëm” dhe ata befafosheshin duke menduar se i kisha hyrë studimit të**

Me Mentor Petrelën për librin  
“Mos bëj dëm” të Henry Marsh

**neuroshkencës. Në fakt, jo. Libri është letërsi me të drejta të plota. Nga ato raste që rrëfejnë një realitet aq të fuqishëm sa nuk lipojnë trillimi. Autorit i mjafton të rrëfejë atë që ka përjetuar dhe aty është gjithë fuqia e trillimit letrar. Letërsia është përplot me libra të tillë... Lexoja dhe më vinte ndërmend Dostojevski që thoshte: Më jepni një tragjedi t’ju jap një kryevepër! Henry Marsh e ka në dorë tragjedinë. Cili është gjykimi juaj në këtë këndvështrim? Pse vendosët ta përkthenit librin, duke dalë jashtë kornizës së profesionit tuaj?**

Ky libër është pjesë e jetës së një neurokirurgu. I përkthyer në 30 gjuhë, shqipja është e 31-ta. Të qenit bestseller ndërkombëtar ishte një shtytë. Tjetra ishte miqësia e gjatë me Henry Marshin... Ai ka ardhur disa herë në Shqipëri. Për hir të marrëdhënies që u krijua preferoi të rikthehet. Dhe rivjen çdo vit e kalojmë 10 ditë bashkë...

**- “Sëmundja si metaforë” thotë Susan Sontag. Ajo, në fakt, e ka fjalën për përdorimin që i bëhet sëmundjes në letërsi, mënyrën sesi ajo metaforizohet. Në realitetin e përditshëm të një neurokirurgu nuk besoj të ketë**

Westminster School janë 3 shkolla prej nga ka dalë pjesa më e madhe e klasës politike angleze, kryeministrat. David Cameron PPE është, dhoma e lordëve në një pjesë së saj... Kështu edhe Henry Marsh, me shkollat që kishte ndjekur dhe mbështetjen që kishte nga i ati, avokat i Amnesty International, këtë destin duhej të kishte...

**- Por nuk ishte vendi i tij...**

Pikërisht. E dini me çfarë mund ta krahasoj? Gogeni me 5 fëmijë, i stabilizuar me familje, punonte në bankë... Një ditë të bukur hoqi manshetat e bankës, i la mbi tryezë, la familjen dhe shkoi në jug të Francës për t’u kushtuar pikëturës...

**- ...Ka histori mjekësh që kanë braktisur mjekësinë për letërsinë... Por dua të këmbëngul te cilësori “i hijshëm”. Ju jeni vetë neurokirurg. Ku qëndron hijësia e një operacioni?**

Nuk është në hijen vetë, por në madhësinë e objektit që lëshon hijen. Ju përmendët pak më lart tragjedinë, por neurokirurgia nuk është vetëm tragjedi. Unë do të përmend Euripidin, tragjeditë e tij që mbarojnë me happy end. Neurokirurgia me rezultatet e saj është më shumë kështu...



Në foto:  
Neurokirurgu  
Mentor Petrela

**vend për metaforat, e megjithatë Marsh një metaforë përdor kur flet për fillosat e veta në një sallë operacioni. Ai thotë: operacioni ishte i hijshëm... Si mundet të jetë? Ç’është ky këndvështrim?**

Duhet të kthehemi pak mbrapa te jeta e Henry Marshit. Ai ishte i destinuar për të qenë njëri administrativ, ose njëri politik, ose në ato organizmat e të drejtës që kanë anglezët. Mjaft t’ju them se Dragon school, PPE në Oksford dhe

**- Por, happy end-i nuk është gjithnjë i garantuar... Henry Marsh thotë, gjithashtu, se “operacioni ishte i rrezikshëm”... Sigurisht, rreziku është joshje. Dikush zgjedh të garojë me makina shpejtësie, dikush të fluturojë me parashutë... Por joshja e zgjedhjes për të cilën flet Henry Marsh nuk ka të bëjë me rrezikun e vetes, por të tjetrit... Si është kjo joshje?**



Në foto:  
Arta Marku në intervistë me  
neurokirurgun Mentor Petrela

Henry Marsh ka edhe një shprehje më të bukur që nuk është në libër: për neurokirurgun rreziku është në çdo qoshe të korridorit. Dhe kjo është e vërtetë. Por është edhe rreziku i vetes, sepse ka një vuajtje të

mia... Sepse vihesh në presionin e vazhdueshëm të adrenalines.

**- Më sollët ndërmend Denis Diderot dhe shkrimin e tij për racionalitetin dhe emocionalitetin të aktorët. Salla e teatrit dhe e operacionit qëndrojnë në dy skaje të papërputhshme, ama diçka i lidh, siç gjykoj unë, nëpërmjet Diderot. Ai thotë se te aktori duhet të mbizotërojë racionaliteti. Nëse do t’i merrte emocionalisht rolet, do të shkatërrohej psikologjikisht. Nuk mund t’i vuajë ai të gjitha emocionet, dramën, përjetimet e fuqishme të çdo personazhi, ndaj i duhet të futet në lëkurën e personazhit duke qenë njëkohësisht jashtë, të mos lejojë që thelbi i vet të preket nga drama e personazhit. Tani le t’i shohim mjekët nga ky këndvështrim: si ia dalin ata të jenë racionalë, të mos preken nga drama e teatrit, për më tepër një njeri i vërtetë e jo personazh letërsie? A e mendon ndonjëherë kirurgu braktisjen e profesionit të vet? Si ndërtohen ekuilibrat?**

Ekuilibrat gjenden. Në zgjedhjen e profesionit të kirurgut hyjnë shumë faktorë. Ka të bëjë me atë që quhet korteksi frontal dhe korteksi post frontal, ajo që na dallon nga primatët e tjerë. Pra, ne, nga speciet e tjera, në mënyrë të thjeshtë na ndan balli, këtu është gjithçka. Këtu është gjithë inteligjenca njerëzore, ajo që quhet ndërgjegjja, aty futen edhe emocionet edhe reaksionet etj., etj. Ajo që sot është në letërsi e përshkruar kaq bukur, ka vendin e saj në biologji. Ka





**Hajdutët me maskë dhe paruke u arratisën me biçikletë**

**24-vjeçari shqiptar grabiti me armë një argjendari në Maltë, kërkohet në gjithë Europën**

**MALTË** - Arrestimet e shqiptarëve jashtë vendit dhe dalja nëpër portalet e huaja janë bërë më së të zakonshme. Së fundmi, forcat policore janë vënë në ndjekje të një 24-vjeçari shqiptar, i lidhur me grabitjen e armatosur të një dyqani bizhuterish të enjten në Sliema, shtetin ishull të Maltës. I riu ka pasaportë shqiptare dhe është identifikuar me emrin Ramadan Hysa. Policia ka bërë apel ndaj kujtdo që ka informacion ndaj shtetasit shqiptar të njoftojë edhe anonim, nëpërmjet numrave që ka lënë në dispozicion, 119/ 21 224001, ose Distriktin Sliema në 2294 3351.

Gjatë grabitjes së të enjtes, shtetasi i dyqanit dhe një punonjësi sigurie në kompleksin e Tigne, Sliema u sulmuan nga dy hajdutë, të cilët ishin të pajisur me armë. Ndërkohë, "tvm.com.mt" të premtën raportoi se Policia po merr masa për të parandaluar të dyshuarit të largohen nga Malta. Gjithashtu, policia ka publikuar një fotografi të një prej grabitësve të përfshirë në ngjarjen së enjtes, ndërsa është vënë në ndjekje të dy grabitësve. "Malta Today" është informuar se policia ka lëshuar edhe një urdhër arresti evropian. "Një persona të enjten vënë në shënjestër një dyqan bizhuterish të Diamonds In-

ternational, duke u larguar me biçikletë me vlerë mijëra euro. Ata ishin të armatosur me 'shotgun' dhe sëpatë. Ata kishin vënë maska dhe paruke dhe u larguan me një makinë të bardhë, të cilën e braktisën në Gzira dhe vijuan arratisjen me biçikletë", thuhet në njoftimin e policisë. Një tjetër rast i kapjes së bandave që përbëheshin nga të rinj shqiptarë është shkatërruar nga policia italiane në Padova pak muaj më parë. Të rinjtë e moshave që variojnë nga 17 deri në 22 vjeç kryenin rreth 4 grabitje në ditë. Gjatë operacionit policor kanë rënë në pranga 10 persona, ndërsa 2 të tjerë janë lënë në arrest shtëpie. Ata ve-



proni kryesisht gjatë natës dhe objektet me vlerë që vidhnin më pas i shisnin. Mediat italiane të cilat cituan autoritetet janë shprehur se grupi ishte i ndarë në 3-4 persona dhe aktiviteti i tyre shtrihej më së shumti në zonën e Bassanello, po jo vetëm. Pjesa më e madhe e të rinjve ishin nga

qyteti i Laçit dhe prej 5 vitesh jetonin në Itali, ku ishin implikuar me bandat që ushtronin rregullisht aktivitetin e tyre duke grabitur. Ata ishin paraqitur në shtetin fqinj si minoranë, mirëpo kjo nuk i ndalonte të vepronin me gjakftohtësi duke vjedhur sende, për t'i shitur më pas nëpër dyqane apo tregje me çmim më të lartë. Shërbimet sociale në Padova i kishin strehuar në vendra sociale derisa të arrinin moshën 18 vjeç. Në krye të grupit ishin dy shqiptarë që mbaheshin si më të shkathtët se anëtarët e tjerë; Mateus Delilaj, 21-vjeçari që njëher ndryshe me pseudonimin Tuci, dhe Ibrahim Sokoli, vetëm 18 vjeç, që thirrje me pseudonimin Ibo. Nuk është rasti i parë ky që të rinj dhe adoleshentët të ikur nga Shqipëria për një jetë më të mirë në vendet fqinje të përfundojnë nëpër rrjetë të tilla të grabitjeve dhe krimeve.

Policia: Mbanin lidhje me ISIS e bënin rekrutime për Al Kaeda. Kishin planifikuar sulme në tempuj, kisha e xhami

**Terrorizmi, arrestohet pedagogu shqiptar në Malajzi**

*35-vjeçari Z.K. u kap së bashku me një grup prej shtatë personash*

Egla Xhemali

**MALAJZI**

Ditën e djeshme është vërtetuar nga policia se shtetasi i akuzuar për terrorizëm është shqiptar. Sipas policisë, i arrestuari nga autoritetet e Malajzisë është Z.K., i cili banon dhe punon prej vitësh në atë shtet, ku dhe ka mbaruar studimet e larta. "Policia e Shtetit konfirmoi se 1 nga 8 të arrestuarit në Malajzi, të dyshuar për terrorizëm, është shtetasi shqiptar Z.K., i cili banon dhe punon prej vitësh në atë shtet, ku dhe ka mbaruar studimet e larta. Strukturat e specializuara të Antiterrorit në Policinë e Shtetit janë duke punuar intensivisht për rastin në fjalë si dhe për të zbuluar nëse ka persona të tjerë të implikuar në këtë aktivitet kriminal. Policia e Shtetit po bashkëpunon me agjencitë e tjera ligjzbatuese e inteligjente në vend dhe jashtë saj, duke shkëmbyer të dhëna", thuhet në njoftimin e policisë. Të shtunën u arrestuan tetë persona të akuzuar për terrorizëm në Kuala Lumpur të Malajzisë. Grupi përbëhej nga 4 malajzianë, 3 filipinas dhe një shtetas shqiptar. Një zyrtar i policisë



**POLICIA**

Burime nga policia mbrëmë konfirmuan se një nga tetë të arrestuarit në Malajzi, të dyshuar për terrorizëm, është shtetasi shqiptar Z.K., i cili banon dhe punon prej vitësh në atë shtet, ku dhe ka mbaruar studimet e larta. Strukturat e specializuara të Antiterrorit në Policinë e Shtetit bëjnë me dije se janë duke punuar për rastin në fjalë dhe për të zbuluar nëse ka persona të tjerë që janë implikuar në aktivitetin kriminal.

deklaroi për mediat se arrestimet u bënë pas pjesëmarrjes së 7 personave të ndaluar në një seri sulmesh gjatë muajt të kaluar. Ndërsa operacioni i dytë i zhvilluar më 1 tetor çoi në

arrestimin e 35-vjeçarit shqiptar, i cili kishte shkuar në Malajzi si i ftuar i një universiteti publik atje. Arrestimi i tyre u bë në 3 qytete të ndryshme të vendit. Sipas policisë, 35-



**SULMET**

35-vjeçari shqiptar luante një rol drejtues në grupin e të arrestuarve dhe detyra e tij ishte të mbante lidhjet me Shtetin Islamik. Krahas lidhjeve me ISIS-in, policia thotë se grupi vepronte edhe për të bërë rekrutime për organizatën terroriste Al Kaeda. Sipas zyrtarëve, ata kishin planifikuar sulme në tempuj, kisha dhe xhami, për të shkaktuar konflikte midis grupeve të ndryshme fetare.

vjeçari shqiptar luante një rol drejtues në grupin e të arrestuarve dhe detyra e tij ishte të mbante lidhjet me Shtetin Islamik. Krahas lidhjeve me ISIS-in, policia thotë se grupi vepronte edhe

për të bërë rekrutime për organizatën terroriste Al Kaeda. Sipas zyrtarëve, ata kishin planifikuar sulme në tempuj, kisha dhe xhami, për të shkaktuar konflikte midis grupeve të ndryshme fetare.

**Sekuestrohet kokainë në Ravena, pranga çiftit shqiptar**

**ITALI** - Policia e Shtetit në Itali ka arrestuar dy shtetas shqiptarë, një burrë dhe një grua, për drogë. Behet fjalë për shtetasit Jurgen S., 41 vjeç dhe partneren e tij E.M., 21 vjeçe. Pas një hetimi intensiv të stilit të vjetër, me ndjekje dhe vëzhgime nga afër, policët e skuadrës së lëvizshme të Ravennas, bashkë me kolegët e Forli, kanë zbuluar një banesë në qendër të Ravennas e përshtatur për aktivitetin e shpërndarjes së drogës. Sipas hetimeve ka rezultuar se shtëpia ishte shumë e frekuentuar nga persona të panjohur dhe të dyshimtë, që vinin nga jashtë qytetit për të përmbytur nevojat e tyre. Operacioni është zhvilluar mbrëmjen e 3 tetorit, dhe policët janë futur në mënyrë të befasishme në banesën e kthyer në bazë shpërndarje, duke i surprizuar dy të huajt. Gjatë kontrollit të banesës, hetuesit gjetën brenda një vazoje të madhe, dy bustina që përmbanin rreth 140 gramë kokainë, dy peshore precize dhe një biçikletë së pakëtuar. Po kështu u gjetën tre telefona celularë, një portofol, dhe një arkë kursimesh që përmbante më shumë se dy mijë euro në kartëmonedha të prerjeve të ndryshme. Në kuadër të hetimit të shqiptarëve u bënë analizat nga policia shkencore dhe u komunikua arresti për posedim droge, me qëllim shpërndarjen dhe më pas u dërguan në burgun e Ravennas dhe të Forlit. Burri kishte disa precedentë edhe për veprat penale të trafikimit të drogës, ndërsa gruaja, e papunë, ka rezultuar e paskeduar nga policia italiane. Hetuesit, dyshues për zotërimin e një pasaportë të re të Jurgenit, kryen hetime të mëtejshme për llogari të tij, nga ku ka rezultuar se ka qenë i kërkuar në vitet 2000. Më pas ai është zhdukur për rreth dhjetë vjet, për t'u rishfaqur me një dokument të ri. Duke lidhur të dhëna të ndryshme dhe duke rindërtuar lëvizjet e tij të fundit në vendet e vaujtjes së dënimt, u bë e mundur që të zbulohej se identiteti aktual ishte i lidhur me një tjetër emër, Julian, subjekt në kërkim që nga viti 2008, mbi të cilin ishte lëshuar edhe një urdhër arresti për vepra penale në lidhje me drogën.



Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

# ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

## Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

**A**gjencia e Trajtimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së gjashtë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe proble-

matika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

### LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E GJASHTË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika	Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika	
Ethem	Kalaj	Ethem	Kalaj	sip. E papercaktuar	Barbullush / 1100	524	vendim negativ për mungese dokumentacioni		Ka vert.pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Sadri	Bala	Riza	Bala	2004m2 truall	Kulumri / 2325		70	2004	2004	Ka dokum.ka dastrak Ka harte
Luke	Kolaj	Luke	Kolaj	Sip. E papercaktuar	Koman / 2290	523	vendim negativ për mungese dokumentacioni		Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Prek	Preka	Mark	Gjini	11224m2 truall	Fushe Arrez / 1656		72	11224	10122	Ka VFJ Ka Harte
Shtjefen	Molla	Shtjefen	Molla	Sip. E papercaktuar	Fshati Rranxe Bushat / 3205	522	S1=4474 m2 truall I lire S2=2026 m2 truall mbi te cilin gjendet nje stalle		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua .Sip. E cituara ne vendim I njihen sipas nenit 4 e 5 te ligjit 7698 dt. 15.4.1993							86		5822	Ka VFJ Ka Harte Me ketë vendim eshte ndryshuar vend. 72 dt.4.9.96, pika 2 e tij ku nga sip. e njohur per kompensim prej 10122, I kthehet sip. 4300m <sup>2</sup> dhe 5822 I mbetet per kompensim.	
Ernest	Koliqi	Elizabeta	Koliqi	Sip. E papercaktuar		521	vendim negativ për mungese dokumentacioni		Ka vert.pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Kole	Mirashi	Gjovalin	Mirashi	22000m2 truall	Fierze / 1619		73	2000	1788	Ka vert.arkivi ka skice
Zef	Brungaj	Zef	Brungaj	Sip. E papercaktuar	Obot / 2819	520	vendim negativ për mungese dokumentacioni		Ka VFJ Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Murrel	Dema	Pjeter	Dema	488m2 truall	Levrushk / 2439		74	488	488	Ka skice
Syle	Sadria	Qamil	Sadria	8000m2 truall	Puke / 3069	91	8000	640	Ka vert.kadastral Ka harte	Gjin	Tushaj	Dila	Deda	9880m2 truall	Fushe Arrez / 1656		75	9880	9880	Ka VFJ Ka Harte
Ndrec	Pjetri	Mrika	Gjinaj	300m2 truall	Fushe Arrez / 1656	68	300	300	Ka vendim KKRT Ka harte	Hile	Nikolli	Mati	Nikolli	7200m2 truall	Bicaj / 1179		77	7200	7200	Ka VFJ Ka Harte
Beqir	Ahmeti(Arifaj)	Mehmet	Arifaj	11840m2 truall	Puke / 3069	69	11840	10804	Ka VFJ Ka Harte	Pjeter	Nikolli	Frrok	Ndoj	7986m2 truall	Fushe Arrez / 1656		78	7986	2053	Ka Dok.kadastral Ka Harte
										Kole	Pjetri	Ndue	Pjetri	4190m2 truall	Lumbardhe / 2522		79	4190	4119	Ka VFJ Ka Harte
										Preng ; Ndrec	Frroku	Prenge	Frroku	51700m2 truall	Puke / 3069		62	20430	11403	Ka VFJ Ka Harte
										Jemin	Rrusta	Adem	Hasani	1500m2 truall	Dedaj Qelez / 1455		63	1500	1500	Ka dok.arkivi Ka harte

Zyber	Malnaj(Breshnaj)	Hamdi	Breshnaj	7000m2 truall	Shtoj l Ri / 3428	124	5700	5700	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Ndue	(Guraleci)	Fran	Guraleci	1500m2 truall	Nicaj Shosh / 2792	112	1500	1500	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Beqo	Pataj	Mehmet	Pataj	5000m2 truall	Shtoj l Ri / 3428	123	4000	4000	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua						112/1		Vendimi eshte per zbatimin e nenit 16 (Kompens imit)	Vendimi nuk u ankimua	
Zyber ; Mustafe	Shpuza	Halit	Shpuza	8600m2 truall	Shtoj l vjeter / 3429	122	8600		Ka nota transkript i Ka vertetim kadastral Vendimi nuk u ankimua	Pjeter	Marku	Pjeter	Marku	14500m2 truall + 1000m2 truall	Velipoje / 3734	111	5350		Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua
Binak	Alia	Ali	Alia	8000m2 truall	Shtoj l Ri / 3428	121	5200	5200	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Loro	Hila	Simon	Hila	650m2 truall	Lac Vau Dejes / 8598	110	650	650	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Brahim	Murati	Aishe	Zhejani	8000m2 truall	Zues / 3949	120	8000	2000	Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Kole	Kovacaj	Filip	Kovacaj	10000m2 truall	Bushat / 1329	109	11275		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Frano	Rushaj	Veneranda	Gjetja	5000m2 truall	Hot l ri / 1965	119	5000	5000	Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Kole	Baltija	Balto	Baltija	19400m2 truall	Shiroke / 8591	108	19400		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Fran	Prela(Selita)	Pale	Selita	6875m2 truall	Velipoje / 3734	118	6875		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Sylo	Hysi	Ramiz	Drabeja	1000m2 livadh	Zues / 3949	107		Mosmirat im kerkese	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Liesh	Paloka	Gjoke	Paloka	5058m2 truall	Gomsiqe / 1799	117	5058	785	Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Luigj	Xhuxha	Ndoc	Xhuxha	300m2 truall	Dajc /1435	106	300		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Fran	Preka	Leke	Preka	5000m2 truall	Luarze / 2500	116	2400		Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Abdullah	Galica	Fatmir	galica	400m2 truall	Shiroke / 8591	105	400	100	Ka VFJ Ka skice Vendimi nuk u ankimua
Kole	Kola	Gjovalin	Kola	850m2 truall	Barbullus h / 1100	115	850		Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua						104/1		Vendimi eshte per percaktim in e mases se kompensi mit	Vendimi nuk u ankimua	
Lacuk	Shtjefni	Gjon	Shtjefni	500m2 truall	Mali Hebaj / 2565	114	500	500	Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Kisha Katolike		Kisha Katolike Berdice e Poshtme		11000m2 truall	Berdice / 1157	103	10100		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Gjon	Gjoni	Gjon	Gjoni	10000m2 truall	Grude e Re / 1869	113	10000	10000	Ka vert.pron esie Ka vert.kada stral Vendimi nuk u ankimua	Nike	Rrotani	Zef	Rrotani	2000m2 truall	Rranxa / 3205	102	2000	2000	Ka VFJ Ka vert.kada stre Vendimi nuk u ankimua
															102/1		Vendimi cakton masen e kompensi mit	Vendimi nuk u ankimua.	

Roza	(Martini)	Mark	Kercaj	10000m2 truall	Grude e Re / 1869	101/1	2280	1080	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
						101/1			Vendimi eshte per caktimin e mases se kompensi m Vendimi nuk u ankimua.		
Ejll	Rrotani	Kole	Rrotani	5400m2 truall	Rranxa / 3205	100	5400	5400	Ka vert.kada stral Ka vert.pron esie Vendimi nuk u ankimua		
						100/1			Vendimi cakton masen e kompensi mit Vendimi nuk u ankimua		
Mehill	Gjoni	Bardhok	Gjoni	9000m2 truall	Flet / 1628	80	9000	9000	Ka VFJ Ka Harte		
Ram	Hasani	Ruzhdi	Pashkja	47531m2 truall	Puke / 3069	81	47531	52.5	Ka VFJ Ka Harte		
Bajram	Kadria	Bajram	Kadria	26000m2 truall	Lajthize Puke / 2370	82	26000	11600	Ka VFJ Ka Harte		
									Ne dosje ndodhet vendimi 24 dt 02.05.199 5,KKKP Bashkia Puke dhe V.13 dt 24.09.94 KKKP Bashkia Puke V.6 dt 24.05.94 KKKP Bashkia Puke V.6/1 dt 16.06.95 KKKP Puke V.16 dt 19.01.95, V.52 dt 21.08.95, Ka VFJ + Harte		
Hydajet	Kuqi	Hydajet	Kuqi	87872m2 truall	Puke / 3069	83	80806	16541			
Selman	Selmani	Ragip	Selmani	700m2 truall	Belaj / 1139	299	700		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Sait	Haxhija	Xhezmir	Isufi	13450m2 truall	Golem / 1790	298	10300	800	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Dul ; Syme	Rexhepi	Ramiz	Collaku	1200m2 truall	Golem / 1790	297	1200		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Met	Ujka	Qazim	Ujka	1500m2 truall	Luarze / 2500	296	1500		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Eljaz	Thaci	Eljez	Thaci	1200m2 truall	Pacram Hajmel / 2851	295	1200	1200	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Asim ; Salim	Kopliku	Arben	Koliku	2600m2 truall	Oblike / 2817			293	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua		
Gjergj	Miri	Gjergj	Miri	33000m2 truall	Luarze / 2500			292	12300	11000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Avdullah ; Hysen ; Brahim	Gjetja	Fatlum	Gjetja	10000m2 truall	Mushan / 2750			291	8600		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ndue ; Fran	Ndrea	Kol	Ndrea	truall mbi te cilin eshte nd. Rep.ushta rak	Rrojll / 1076			290	1600		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Hajdar	Dini	Myftar	Babaj	20000m2 truall	Mjede / 2702			268	10000		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Martin	Ivanaj	Pjeter	Ivanaj	22000m2 truall	Baks I Ri / 1075			287	11200	10200	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Mark	Ujka	Mark	Ujka	20000m2 truall	Baks I Ri / 1075			286	11000	3400	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ndue	Gjoni	Marash	Gjoni	10600m2 truall	Velipoje / 3734			286	10600	9800	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ndue	Topalli	Gjenarin	Topalli	38000m2 troje	Melgushe / 2664			284	12800		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Selim ; Jonuz ; Osman	Bashliqi	Zija	Bashli	2000m2 truall 15000m2 truall	Trush / 2664			283	10500	10500	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ndue	Prenga	Zef	Prenga	500m2	Gomsiqe / 1799			282	500	500	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Lin	Kraja	Lin	Kraja	483.6m2	Shiroke / 8591			281	483.6	483.6	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Shaqe	Urbani	Aleksander	Urbani	288m2 truall	Shiroke / 8591			280	150	100	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Teufik	Kurti	Teufik	Kurti	Sip. E papercakt uar				549	vendim negativ per mungese dokumen tacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Dede	Shala	Dede	Shala	Sip. E papercakt uar				548	vendim negativ per mungese dokumen tacioni		Ka VFJ Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua

(Vijon nesër)

Dje në "Zëri i Amerikës"

# "Burning Man" dhe qyteti i lirisë ekstreme

Genia Dulot

Çdo vit, për vetëm një javë, një "qytet" lind në shkretëtirën e Nevadës, Qyteti Shkëmbi i Zi, ku ka vetëm tre rregulla: vetëbesim ekstrem, liri për t'u shprehur dhe dhurime. Kjo traditë e quajtur "Burning Man" ekziston tashmë prej 30 vitesh. Themeluesit e saj donin të ndërtonin një komunitet që dëshiron të jetojë në kundërshtim me ligjet bazike të një shoqërie moderne kapitaliste. Gazetarja e "Zërit të Amerikës", Genia Dulot, e ka prekur nga afër këtë projekt utopi. "Burning Man" ndodhet në një shkretëtirë të largët të Nevadës, tri orë larg me makinë nga qyteti më i afërt. Telefoni aty nuk punon. Ndonëse gjatë ditës temperatura është 40 gradë celsius, gjatë natës bie nën zero, madje shpesh ka stuhi rëre vdekjeprurëse. Por, pavarësisht nga kushtet ekstreme klimatike, 70.000 njerëz e vizitojnë qytetën e sajuar çdo vit për një javë.

Jett është 11 vjeç, por është viti i 12-të që vjen në "Burning Man"; herën e parë që erdhi këtu, ai ishte akoma në barkun e së ëmës. Jettit i pëlqen t'i japë një makine-peshkaqen gjigante, të cilën e ka ndërtuar shumë vite më parë e ka baba i tij. Pjesë e traditës në këtë aventurë është edhe "spërkatja" me akull. Jetti është i vetëdijshëm se parimi kryesor i Qytetit Shkëmbi i Zi është vetëbesimi radikal. Kjo është lista e tij me gjërat më të



nevojshme: "Akull, ujë, maskë, krem mbrojtjeje nga dielli etj."

Michael, një veteran i kësaj tradite, vjen këtu me të bijën. Së bashku, ata kanë ndërtuar një dragua me rrota e pedale, që lëshon flakë.

"Mendoj se thelbi i 'Burning Man' është liria për të krijuar dhe shfrenuar fantazinë. Ideja është të kalosh çdo kufi, ta teproshe t'i bësh njerëzit të mendojnë: 'Uau, ku i paska vajtur mendja!'" thotë Michael.

Liria për të krijuar është ligji në Qytetin Shkëmbi i Zi.

Liria ekstreme për të shprehur veten është një tjetër parim thel-

bësor në "Burning Man". Ka njerëz që rrinë lakuriq, disa vishen me kostume interesante dhe të tjerë kanë një dragua që ecën me rrota e nxjerr flakë. Në "Burning Man" nuk ka para. Në vend të tyre, pjesëmarrësit shkëmbejnë dhurata. Nuk ka rëndësi çfarë jep, në fund, gjithkush do, ha dhe pi ujë falas. Madje pa pagesë mund të postosh edhe letra në çdo vend të botës apo të rregullosh biçikletën.

"Për shembull, nëse unë i rregulloj biçikletën dikujt, kam besim se ai njeri do i bëjë më pas masazh falas dikujt që gatuan sanduiçet me të cilët unë do ushqem. Këtu

nuk ka nevojë të mbajmë shënime se çfarë bën secili prej nesh. Thjesht i besojmë njëri-tjetrit. Besojmë se të gjithë do të bëjmë çfarë duhet dhe aq sa duhet që këtij vendi të mos i mungojë asgjë", - thotë Max, një pjesëmarrës.

"Burning Man" është ëndërra për një botë më të mirë, një eksperiment social ku njerëzit mblidhen, lënë pa monotoninë e jetës së përditshme dhe kanë besim të verbër te njëri-tjetri. Është një arratisje nga bota kapitaliste ku jetojnë dhe utopia e izolimit në shkretëtirë, për një javë, duket se funksionon për ata që shkojnë aty.

## Spanjë, demonstrata pro unitetit spanjoll

Mijëra njerëz u bashkuan në një tubim në Barcelonë të dielën për të protestuar kundër shtytjes së qeverisë katalonase për shkëputje nga Spanja. Anketat kanë sugjeruar se më shumë katalonas preferojnë të rrinë të bashkuar me Spanjën sesa të shpallin pavarësinë.

Tubimi vjen një javë pas një referendumi në të cilin katalonasit votuan me shumicë dërrmuese për pavarësinë. Në atë sondazh, që konsiderohej i jashtëligjshëm nga Madridi, 90 për qind votuan për t'u shkëputur nga Spanja, por pjesëmarrja ishte shumë më pak se gjysma e elektoratit.

Protestuesit u mblodhën në sheshin "Urquinaona" të Barcelonës duke kënduar "Viva Espana".

Presidenti katalonas Carles Puigdemont është zotuar të punojë për arritjen e pavarësisë.

Në një intervistë me gazetën "El País", kryeministri Mariano Rajoy tha se nuk do të përjashtojë përdorimin e kompetencave kushtetuese për të hequr statusin autonom të Katalonjës në qoftë se rajoni deklaroi pavarësinë.

"Të jeni të sigurt se qeveria do



të parandalojë që çdo deklaratë e pavarësisë të kthehet në diçka konkrete. Spanja do të vazhdojë të jetë Spanja dhe do të vazhdojë të jetë e njëjta për një kohë të gjatë".

Kryeministri Rajoy i tha gazetës "El País" se politika katalonase ishte rrëmbyer nga radikalët dhe duhej të kthehej në një pozitë të moderuar.

"Tani ata i janë futur një rruge që nuk të çon askund, ata kanë

zgedhur radikalizmin që pengon çdokënd për të pasur ndikim dhe pengon ndërtimin e diçkaje që ndihmon bindjet tuaja. Radikalizmi ka çuar në këtë proces ndarës që po ndodh tani, ka shkaktuar shqetësim të madh të të gjithë, madje edhe largimin e kompanive. Është vërtet e pabesueshme sa shumë kompani të rëndësishme po braktisin Katalonjën, që largohen sepse duhet të largohen, të

mbrojnë bilancin e tyre, punëtorët e tyre dhe pagat e tyre. Duhet të kthehet katalonizmi i moderuar", - shtoi Rajoy.

Më parë të shtunën, mijëra protestues u mblodhën në mitingje në Barcelonë, Madrid dhe në qytete të tjera spanjolle.

Organizatorët e mitingut pro ndarjes në Katalonjë u kishin kërkuar demonstruesve të visheshin me të bardha dhe të mos shfaqnin ndonjë flamur, qoftë spanjoll ose të Katalonjës. Organizatorët e demonstratave kanë promovuar sloganin "Le të flasim".

Po ashtu në Madrid, kryeqytetin spanjoll, u mbajt një demonstratë për unitetin spanjoll, ku morën pjesë mijëra njerëz që valëvitnin flamur kuq dhe verdhë të Spanjës.

Disa shtete të BE-së janë të shqetësuar se biseda për pavarësinë katalonase mund të ushqejë ndjenjat ndarëse në pjesë të tjera të Evropës.

### HOROSKOPI

**DASHI**  
Ngjarje të rëndësime të lidhura me punën, që janë bërë më urgjente me lëvizjet e Jupiterit jo shumë miqësor, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e jetës në çift. Nuk do të jetë e lehtë të gjeni një ekuilibër midis jetës private dhe profesionale, por ju do t'ia dini.

**DEMI**  
Jeni të shpërqendruar disi, por fatmirësisht do të arrini t'i fshihni mirë dobësitë e juaja. Nuk do të keni probleme. Nëse nuk e dini diçka, mos bëni sikur e dini. Më mirë të thuash menjëherë të vërtetën, për të shmangur gjera të pakëndësime.

**BINJAKET**  
Një shëtitje jashtë shtëpisë është ajo që ju duhet për t'u shkëputur nga rutina e përditshme e ndoshta edhe për të vizituar vende të reja dhe interesante. Keni nevojë të ushqeni fantazinë e juaj, dhe leximi i një libri të mirë mund të jetë ajo për të cilën keni nevojë.

**GAFORJA**  
Nëse ke zarritur për në fund detyrat më të mërzitshme, tani duhet të bëni përmirësime. Kjo është e vetmja rrugë për t'i rimarrë gjërat në dorë. Lërimi mënjane projektet fantastike, që nuk kanë lidhje me realitetin, kthehuni me këmbë në tokë.

**LUANI**  
Favorizimi i planetëve nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë, për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengesë. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani më në fund gjithçka zhblokoohet. Përfillon nga mundësia për të menduar për të ardhmen.

**VIRGJERESHA**  
Për të hequr ndonjë mendim jo shumë pozitiv, mendoni për çdo gjë të bukur në jetën e juaj. Menjëherë do ta kuptoni se jeni shumë më faturë ndryshe nuk është e gabuar, por para se të veproni duhet të keni në mendje në projekt shumë të qartë.

**PESHORJA**  
Puna e mërzitshme mund të presë, sot për ju vetëm argëtim dhe hobi të shëndetshme dhe të këndshme. Kështu mund të kaloni kohën duke pikturuar, apo edhe pas sobës, duke përgatitur ushqime të shijshme!

**AKREPI**  
Paqëndrueshmërisë suaj i bashkohet edhe nervozizmi, duke krijuar një miks jo të këndshëm. Më mirë të gjeni zgjidhje dhe të mos kërkoni më shumë probleme. Nëse sot nuk do të punoni, do keni kohë për të bërë pazare për të blerë gjëra që ju pëlqejnë.

**SHIGJETARI**  
Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë, edhe falë pozicionit të Jupiterit me shenjën e juaj si edhe mundësisë që keni për t'i shtuar talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja se do t'ju ndjekin pa u sturuar.

**BRICJAPI**  
Keni përjashtuar një person pa u menduar shumë, por tani duhet të ndreqni situatën, duke qenë se e keni kuptuar si është puna. Ju takon të bëni një hap mbresa. T'u riktheheni gjërave është një lëvizje e zgjuar, kur e keni kuptuar se keni gabuar. Më mirë vonë se kurrë!

**UJORI**  
Bashkëprejimi i planetëve mund të krijojë mundësinë e duhur për të menduar rreth asaj gjëje që doni me të vërtetë, duke braktisur drejtimet që nuk sjellin gjë. Një përzierje fizike e tepërt mund të t'ju krijojë shqetësime. Prandaj merruni me sport, por me masë.

**PESHQIT**  
Të humbësh një mundësi të mirë nuk është e këndshme, por tani mos e dramatizoni. Kërkoni të tjera, ndoshta edhe më të mira, kështu do të keni diçka për t'u ngushtuar. Mos u dekurajoni përballë dëshimeve të ndokujt. Nevojitet kohë për t'ia dalë që ta bindni.

# Katovica

## Shqiptarët nuk duhet të votojnë partitë maqedonase

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Duke maqedonizuar votën, zgjedhësit shqiptarë heqin dorë vullnetarisht nga të drejtat kombëtare dhe nga identiteti i tyre kombëtar.



... e tij kombëtare, politike, administrative, ekonomike, kulturore, sociale, etj. të barabarta me popullin maqedonas. Veçori e zgjedhjeve të tanishme lokale është se shqiptarët vijnë në këto zgjedhje me një fenomen të ri negativ, i cili u shfaq me përmasa shqetësuese në zgjedhjet parlamentare të dhjetë muajve më parë. Ky është fenomeni i kalimit masiv të votave të shqiptarëve në fondin elektorat të partive politike maqedonase, pra maqedonizimi i votës shqiptare. Rrjedhja apo humbja e 60-70 mijë votave shqiptare në favor të partive maqedonase, në zgjedhjet e fundit parlamentare, të 11 dhjetorit 2016, as nuk konsolidoi pozitën politike dhe shtetërore të popullit shqiptar në Maqedoni dhe as solli ndonjë kthesë drastike pozitive në realizimin e barazisë së të drejtave midis dy popujve nga partia maqedonase, që i mori ato vota dhe erdhi në pushtet. Ai fenomen shkaktoi dobësimin e faktorit politik shqiptar në Maqedoni, i cili për këtë arsye ka dhjetë deputetë më pak sot në parlamentin e Maqedonisë. Është një fenomen i panatyrshëm elektorat, politik dhe kombëtar, i cili kërkon analiza serioze nga faktori politik shqiptar se cilat janë shkaqet që shpërtheu befasisht kjo llavë votash shqiptare për partitë maqedonase. Sepse nuk mund ta pranohet logjika, për shembull, që Haraçina në vitin 2014 i dha partisë LSDM vetëm 8 vota, dhe në vitin 2016 e nxjerr fituese me 2059 vota këtë parti maqedonase, duke përgënjeshtuar identitetin e vet shqiptar.

Dy partitë kryesore politike maqedonase, Lidhja Socialdemokrate, LSDM, dhe partia VMRO-DPMNE, duke parë autogolin elektorat dhe politik të shqiptarëve, janë angazhuar në një fushatë të gjithanshme për ta përsëritur fenomenin e rrjedhjes së votave të shqiptarëve në kutitë e votimit të partive maqedonase. Pragu i 15 tetorit të zgjedhjeve lokale është një moment i rëndësishëm reflektimi për elektoratin shqiptar; për partitë politike shqiptare, për qarqet akademike dhe shoqërinë civile shqiptare, për mediat dhe rrjetet shoqërore shqiptare dhe për gjithë popullin shqiptar atje lidhur me efektet dhe pasojat negative të përsëritjes së fenomenit elektorat të dëmshëm të dhënies së votave shqiptare për partitë maqedonase. Përsëritja e këtij fenomeni do t'i hiqte nga duart shqiptarëve një pjesë të mirë të pushtetit lokal, që kanë pasur deri tani, dhe që do t'i kalonte partive politike maqedonase.

Gjatë gjithë periudhës nga zgjedhjet e fundit parlamentare në zgjedhjet e tanishme lokale dy kanë qenë tezat kryesore në Maqedoni për të shpjeguar këtë zhvillim negativ në gjirin e elektoratit shqiptar: Teza e parë është se elektorati shqiptar e bëri këtë devijim, sepse u zhgënjye nga partitë politike shqiptare, të cilat nuk mbajtën premtimet për avancimin e pozitës së shqiptarëve, të cilat u zhytën në korrupsion dhe udhëheqësit politikë shqiptarë u komprometuan me pushtetin maqedonas, etj. Është një tezë, e cila nuk e përligj lëshimin e votës të partitë politike maqedonase. Nuk e përligj, sepse dy partitë politike maqedonase, që kanë alternuar pushtetin që nga viti 1991 i krijimit të shtetit të Maqedonisë, nuk kanë mbajtur asnjë nga premtimet e bëra për barazinë e popullit shqiptar me popullin maqedonas. Madje në disa drejtime, si ajo të drejtës së popullit shqiptar për shtetformësi, qeveritë e Maqedonisë pas vitit 1991 e bënë më keq statusin juridik të

shqiptarëve se sa në kohën e ish-Federatës komuniste jugosllave.

Partitë maqedonase janë më të korruptuara se partitë shqiptare, sepse janë ato që i kanë në dorë të gjitha levat e administrimit të ekonomisë dhe të pasurive të vendit dhe korrupsionin e kanë bërë bashkë. Zhgënjimi nga partitë politike shqiptare nuk përligj aspak dhënien e votës për partitë maqedonase. Spektri i partive politike shqiptare është shumë i gjerë me mundësitë për t'ia dhënë votën qoftë partive shqiptare, që janë alternuar në pushtet bashkë me partitë maqedonase, qoftë partive shqiptare, që nuk kanë qenë në pushtet deri tani dhe nuk janë provuar. Nuk arrihen qëllimet duke hequr besimin nga partitë shqiptare dhe duke ia dhënë besimin partive maqedonase, sepse, siç thotë një proverb i qytetit tim të lindjes "Me dorë të huaj mos vrafsh as gjarpurin".

Teza e dytë, e qarkulluar për të shpjeguar fenomenin e votave shqiptare për partitë maqedonase është ajo që elektorati shqiptar

me maqedonizimin e votës shqiptare ka demonstruar nivel qytetar, sepse duhet të votojë jo parti etnike, por parti qytetare. Kjo është tezë levantinësh, të cilët spekulojnë me nivelin kulturor të formimit të elektoratit shqiptar; dhe ta shesin maqedonizimin e votës shqiptare si avancim modern e qytetar. Levantinët shqiptarë nuk e thonë përse nuk e bënë elektorati maqedonas këtë "zhvillim qytetar" dhe të votojë për partitë politike shqiptare, dhe pse duhet ta bëjnë këtë vetëm shqiptarët. Nuk mund të ndodhë kurrë që një fshat maqedonas t'ia japë votat një partie shqiptare.

Duhet të bëhet e qartë se shqiptarët, që dhanë votat për LSDSM apo për VMRO, nuk i dhanë për parti qytetare, por i dhanë për partitë etnike maqedonase. Edhe LSDM, edhe VMRO, janë parti etnike maqedonase dhe vo-

tat e atyre dhjetëra-mijëra shqiptarëve në zgjedhjet e kaluara parlamentare nuk i shndërrojnë në qytetare as LSDM-në e as VMRO-në. Të dy partitë kryesore maqedonase kanë programe politike dhe qeveritare në shërbim të popullit maqedonas dhe jo në shërbim të popullit shqiptar në Maqedoni. Asnjë parti politike maqedonase nuk ka në programin e saj dy parametraj kryesore të identifikimit qytetar: dhënia popullit shqiptar të statusit shtetformues me Kushtetutë dhe dhënia e statusit të gjuhës zyrtare, gjuhës shqipe në të gjithë Maqedoninë. Ato 60 apo 70 mijë vota që shqiptarët dhanë për partinë e Zoran Zaevit shkuan dëm dhe nuk e qytetëruan aspak atë parti maqedonase, siç tregon fakti i madh që në zgjedhjet e tanishme lokale partia LSDM e Zaevit nuk ka vënë asnjë kandidat shqiptar në komunat me përbërje multietnike. Po ashtu ka vepruar edhe partia VMRO.

Sado indulgjent që të tregohesh, është e vështirë të zbulosh qoftë edhe një element minimal përfitimi nga derdhja e votave shqiptare në kutitë e votimit të partive maqedonase. Cuarja dëm e dhjetëramijëra votave të shqiptarëve vetëm forcon dhe konsolidon pushtetin

politik të partive maqedonase dhe dobëson faktorin elektorat dhe politik shqiptar. Shqiptarët në Maqedoni duhet të kuptojnë se votimet dhe zgjedhjet kanë një kuadër të hekur brenda të cilit zhvillohen marrëdhëniet politike, marrëdhëniet ndëretnike dhe jeta politike, dhe ky është kuadri kombëtar. Diskriminimet e gjithanshme, që vuan populli shqiptar nga pushteti maqedonas, vijnë për shkak të identitetit kombëtar të ndryshëm dhe ata trajtohen si qytetarë të kategorisë së dytë, sepse janë shqiptarë. Shqiptarët si popull nuk kanë zgjidhur akoma në Maqedoni statusin e trajtimit kombëtar shqiptar; që do

të thotë statusin e tyre të barabartë juridik me popullin maqedonas. Logjika dhe përvoja historike më minimale mësojnë se në një shtet binacional, çdo popull si prioritet duhet të zgjidhë statusin e tij kombëtar dhe pastaj të përqendrohet në statusin social. Nëse të gjitha qeveritë maqedonase dhe partitë politike maqedonase e kanë trajtuar popullin shqiptar si refugjat, kjo përbën një problem ekzistencial kombëtar dhe jo social. Kjo dikton prioritetet për popullin shqiptar atje, që të mobilizohet të votojë dhe të forcojë faktorin politik shqiptar në Maqedoni për t'i imponuar pushtetit maqedonas barazinë kombëtare të statusit dhe të vendimmarrjes në shtetin e Maqedonisë. Siç kam theksuar në librin tim "Shqiptarët e Maqedonisë-prioriteti i çështjes shqiptare", (Tiranë, 2016), çështja e shqiptarëve të Maqedonisë është një çështje e pazgjidhur kombëtare.

Partitë politike shqiptare në Maqedoni kanë shumë mëkate dhe difekte të manifistuar gjatë 26 viteve të shtetit të ri të Maqedonisë. Dobësitë e tyre nuk mund të shihen të shkëputura nga dobësia e elektoratit shqiptar, që i ka zgjedhur ato, as të shkëputura nga dobësia e klasës intelektuale dhe e qytetarëve shqiptarë në Maqedoni.

Çështja më e rëndësishme se statusi kombëtar i përcaktuar i popullit shqiptar mund të vonohet nga dobësitë e partive shqiptare, por nuk mund të zgjidhet kurrsesi nga partitë maqedonase, të cilat kanë në program dhe vijën e qeverisjes krijimin dhe konsolidimin e shtetit një nacional maqedonas. Duke votuar partitë maqedonase, shqiptarët votojnë për këto programe e vija qeverisjeje një nacionale maqedonase dhe këtë duan ta mbulojnë tymnajat "qytetare" të levantinëve ruralë të sponsorizuar.

Duke maqedonizuar votën, zgjedhësit shqiptarë heqin dorë vullnetarisht nga të drejtat kombëtare dhe nga identiteti i tyre kombëtar. Ata vetë humbasin të drejtën morale të kërkojnë trajtim të barabartë me popullin maqedonas, sepse vota e maqedonizuar i shkrin me elektoratin maqedonas. Pa ia imponuar nëpërmjet faktorit politik shqiptar qeverive maqedonase dhe partive maqedonase statusin e barabartë kombëtar me popullin maqedonas në legjislacion, në Kushtetutë dhe praktikë, votuesit shqiptarë mund të rrinë edhe dhjetë brezë duke fryrë sytë nga qielli maqedonas për të pritur t'iu zbresë statusi i qytetarit.

Fenomeni negativ i derdhjes së votave shqiptare në kutitë e partive maqedonase është një fenomen, i cili po të tolerohet e të neglizhohet, mund të ketë pasojë të rënda për të drejtat kombëtare dhe statusin e popullit shqiptar në Maqedoni. Partitë politike shqiptare, intelektualët, shoqëria civile, institutet, mediat shqiptare, rrjetet sociale, etj. duhet të bashkohen dhe të punojnë fort që të mos përsëritet dhe tani në zgjedhjet lokale ky fenomen negativ elektorat, sepse ai dëmton të gjithë shqiptarët, dëmton çështjen e popullit shqiptar në Maqedoni.

Ndaj, në prag të ditës së votimit për zgjedhjet lokale, apeli shkon të bashkëkombësit tanë, familjet shqiptare, të gjithë personalitetet në skenën politike, akademike, artistike, kulturore, arsimore, fetare, etj. të shqiptarëve në Maqedoni, që të bashkohen për të ndaluar fenomenin negativ të maqedonizimit të votës shqiptare. Avancimi i statusit kombëtar të popullit shqiptar në Maqedoni do të sjellë përmirësimin e statusit të tyre qytetar dhe jo e kundërta. Vota është e shqiptarëve dhe duhet të mbesë të shqiptarët.

Vota është e shqiptarëve  
dhe duhet të mbesë  
të shqiptarët.

**KAPITENI**

**Agolli: Italia të ngre adrenalinën**

Kapiteni i Kombëtares Shqiptare, Ansi Agolli, tregon se gjendja e tij fizike ka ardhur në përmirësim dhe është i gatshëm për ta përballur ndeshjen ndaj Italisë. Në konferencën për shtyp para takimit, ai tha se për kuqezinjtë nuk kanë rëndësi vetëm rezultatet, por edhe ngritja e nivelit të lojës. "Kam punuar mirë këtë periudhë. Jam mjaft mirë fizikisht. Gjithmonë gjendja ka ardhur duke u përmirësuar. Janë dy skuadrat nga më të mirat në botë. Sidomos Spanja. Duhet një gjendje fizike e mirë për t'i përballuar. Këto ndeshje përjetohen



me emocion ndryshe. Këto janë ndeshje që të ngrenë adrenalinën, në qoftë se misteri do më fusë në formacion. I kemi analizuar gabimet e bëra me Spanjën. Nuk është i rëndësishëm vetëm rezultati, por të ngrihem sa më shumë në lojë tonë."

**TË KALTRIT DREJT SHKODRËS**

**Italia zbret në Shqipëri nën masa të rrepta sigurie**

Skuadra e Italisë ka mbërritur në Shqipëri. Avioni me Kombëtares Italiane në bord ka prekur tokën shqiptare në orën 17:30 të së dielës, ndërsa pas rreth 15 minutash, lojtarët dhe stafi i të kaltërve kanë hipur në autobusin me të cilin kanë udhëtuar menjëherë drejt qytetit të Shkodrës, ku të hënën, në stadiumin "Loro Boriçi", në orën 20:45 do të luajë ndaj Shqipërisë. Përfaqësuesja e Italisë është shoqëruar nën masa të rrepta sigurie, ndërsa në eskortën e tyre ka qenë edhe një furgon i forcave RENE. Italia nga



ana e saj ka kërkuar siguri absolute, ndërsa ka prenotuar të gjithë hotelin ku do të akomodohet në Shkodër si edhe ka sjellë ushqimet me vete. Kuj-

tojmë që Italia zbarkon për herë të parë në Shqipëri në kuadër të një takimi zyrtar, siç është përballja e nesërme në "Loro Boriçi".

Trajneri i Shqipërisë pret një kundërshtar të nevrkosur në fushë pas kritikave të fundit

**Kristian Panuçi: Italia? Në mbrëmje jam shqiptar**

*Italiani beson te forca e lojtarëve kuqezi*



Jeton Selimi

Kristian Panuçi do ta ndjejë dyfish takimin e fundit në grup ndaj Italisë. Ish-lojtari axurr që numëron 57 ndeshje me fanellën e Italisë beson se Shqipëria do të bëjë një ndeshje të mirë dhe se në fund do të jetë krenar për paraqitjen e lojtarëve. Ai pret një sfidë të luftuar në "Loro Boriçi", pasi Italia vjen nga një periudhë e mbushur plot kritika për lojën e saj. "Për sa i përket ndeshjes, jam italian dhe jam krenar që jam trajner i Kombëtares Shqiptare. Do jem në fushë me djemtë e mi. Do isha i lumtur në qoftë se djemtë do ia dilnin dhe të kishin një sukses. Vlej më shumë sesa mendojnë. Jam i bindur që do bëjmë një ndeshje shumë të mirë. Pres një Itali të inatosur, sepse po merr shumë kritika. Do vijë për të bërë një ndeshje shumë serioze. Dua të kënaqemi me një rezultat shumë të mirë."



Panuçi kërkon që të ruajë përqendrimin e lojtarëve për sfidën e së hënës, pasi përballja me të kaltrit luhet në kushte kur në grupin G çdo gjë është vulosur me Spanjën që kualifikohet direkt dhe Italinë që do të luajë në play-off, ndërsa thekson Senga futbollistët pret që të japin maksimumin. "Kjo nuk është një miqësore dhe për të luajtur në Kombëtare duhet të japësh maksimumin, këtë do bëjmë në ndaj Italisë. Për ne vlen të luajmë mirë dhe të fitojmë ndeshjen. Dua që lojtarët e mi të mos kënaqen, sepse kanë potencial për të bërë më shumë. Pres maksimumin nga ata. Në takimin ndaj Spanjës kam bërë ndryshime në pjesën e dytë, kam

si në pjesën e dytë ndaj Spanjës dhe se humbja nuk e shqetëson pasi në Alikante, kuqezinjtë u mposhtën nga më të mirët. "Kur Shqipëria luajti me Spanjën këtu në Shqipëri, miqtë kanë bërë lojë më të egër,

ndaj mund të themi se bëmë një lojë të mirë. Pas humbjes kemi bërë disa ndryshime, të cilat shpresojmë të rezultojnë pozitive. Humbja nuk ishte e lehtë, por nuk jemi vetëm ne që kemi humbur ndaj më të mirëve. Dua të theksoj se në Spanjë kemi gjuajtur 14 herë në portën kundërshtare dhe kemi krijuar 7 raste goli. Dua që ndaj Italisë ta nisim nga pjesa e dytë që bëmë në Spanjë."

Në përballjen e së hënës në Shkodër, Panuçi do të ketë shërbimet e Mavrajt, Kukulit dhe Roshit, të rikthyer nga pezullimi, por nuk do të ketë të disponueshëm Xhakën dhe Llullakun që kanë plotësuar numrin e kartonëve të verdhë.

**TRAJNERI I ITALISË**



**Ventura: Shpresoj që të jetë një festë**

Para ndeshjes me Shqipërinë ka folur për mediat dhe trajneri i Italisë, Ventura. Italiani tha për "Supersport" se shpreson që të jetë një ndeshje festive midis dy skuadrave dhe se ekipi është i lumtur që luan në Shqipëri ku ka dhe shumë tifozë axurrë. Ventura foli dhe për ish-futbollistin e tij të Torino, Migjen Basha për të cilin tha se i del përherë para, në Bari, ku dhe ai jeton. "Është një ndeshje historike, pasi është hera e parë midis dy vendeve që bëhet një ndeshje zyrtare në Shqipëri, ku kemi dhe shumë tifozë. Është e rëndësishme që të jetë një ndeshje si ajo në Itali, që ishte festive, pasi të dyja skuadrat i kanë mbyllur tashmë llogaritë. Ka një rëndësi të madhe edhe për Kombëtares Italiane, pasi do të jetë e vështirë që të motivosh lojtarët pasi mendojnë, se pikët nuk duhet më, por në të vërtetë ato duhen. Basha është një lojtar i rëndësishëm që e kam pasur të Torino dhe që luan aktualisht te Bari, aty ku unë jetoj, dhe më del përditë përpara. Shpresoj që të jetë një atmosferë festive dhe një ndeshje festive."

**Portieri ka luajtur kundër Teutës**


**Bufon: Rikthehem pas 20 vjetësh në Shqipëri**



Para ndeshjes me Shqipërinë ka folur për mediat dhe kapiteni i Italisë, Xhanluixhi Bufon. Bufon tha për "Supersport" se Shqipëria i pëlqen shumë si vend, pasi ka gjërë të ngjashme me Italinë. "I pyetur se çfarë i pëlqen nga vendi jonë, ai tha se i ka bërë shumë përshtypje shprehja: "Feja e shqiptarit është shqiptaria". "Kam qenë 20 vjet më parë në Shqipëri në ndeshjen me Teutën. Jam shumë i lumtur që luaj në Shqipëri, është një vend që më pëlqen shumë me të cilin kemi shumë të përbashkëta. Më bëhet qejfi

që Shqipëria shkoi në Europian, pasi trajner ishte një italian dhe ishim dhe ne pjesë e kualifikimit historik. Shqipëri-Itali mund të jetë edhe një tip derbi, pasi shumë shqiptarë të Kombëtares kuqezi janë rritur dhe formuar në Itali. Panuçin e kam pasur dhe shok skuadre dhe shpresoj që të arrijë sa më shumë me kuqezinjtë. Çfarë më pëlqen nga Shqipëria?! Kam lexuar libra për këtë vend dhe ajo çka më ka bërë më shumë përshtypje ishte shprehja: "Feja e shqiptarit është shqiptaria", kjo tregon shumë për vendin tuaj dhe lidhjen që kemi me të."

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë kursimi
5. Një luhet nga banda
8. I kanë tek poret.
11. Eshhtë konfuzion i madh.
13. Ndiqet me bama.
14. Ngrihet me dolla
17. Janë në skaje.
18. Ai dhe ajo.
19. Mund të jenë celularë.
21. Mund të klasifikohen në ATP.
22. Fillojnë hapur.
24. Janë mbulesa... mbi hambarë.
27. Mund jenë fetare.
28. Eshhtë edhe ai shiatik.
29. Fillojnë sefte.
31. Një këshilltar për negus.
32. Ishte zonjë romake.
36. Eshhtë rebelim.
39. Liam i Schindler's list.

40. Në krye të klasifikimit.
41. Oliver që qe aktor.
42. Inicialet e Depardieu.
43. Centrale Rajonale Tiranë.
44. Muhamad i ringut.
46. Gjysma e arenës.
48. Pret fëmijë një e tillë.
49. Nuk ka harbuti
50. Dickinson poete.
51. I ka të ndryshme një trakt

**VERTIKAL**

1. Fillojnë aktivitetin.
2. Një mund të jetë i rralë.
3. Më e mira është rekord.
4. Haset pa kufij.
6. Marco, portier italian.
7. Jonathan i Gulliver.
8. Nuk i pëlqen dëmbelit.
9. Mund të jenë çiklistike të tilla.
10. Gjysmë tati.
12. Mund të jenë kohore.
13. Mund të jenë ndërtimi dhe detare të tilla.
15. Bën ura të arta të tilla.
16. Një provë.
18. Gjysmë arkivi.
20. Christian i fushës magnetike.
21. Një mund të ishtrohet edhe psikologjik.
23. Eshhtë pakti ku aderojmë.
25. Mbyllin krahun.
26. Fillojnë vetëm.
30. Mund t'jenë edhe ambalazhi.
33. Në mes të Miguel edhe Asturias.
34. Emri i Wilde.
35. Opera e Bellini-t.
37. Fitzgerald këngëtare.
38. Smith Filozof.
45. Diku në qendër.
47. Fund janari.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Eshhtë për medaljen e parë.
5. Një tip... kërcimi.
7. Mula këngëtare lirike.
11. Nuk di të tradhtëojë.
13. Një ndalim... edhe shtëpie .
15. Inicialet e Delon.
16. Një shpërbllim në para .
18. Ishin 12 ato të Herkullit.
20. Fillojnë detyrën.
21. Një është i ndaluar në kthesë.
23. Gjysmë fatale.
24. Eshhtë figurë letrare.
26. Burton regjisor
27. Pal likantropi.
29. Entë Ekonomike Autonome.
30. Gjysmë stoike.
32. U printe hunëve.
34. Ndërmarrje Ndërkombëtare Transporti.
35. Eshhtë formë sapuni

**VERTIKAL**


1. Tabak pa kufij.
2. Dridhen pa dhen.
3. Fise pa fe.
4. Janë reaksionet në provëza
5. Eshhtë kujdes për të miturin
6. Eshhtë princip.
7. Me dies në liturgji.
8. Ngelur pa gur
9. Kufijtë e vetes.
10. Eshhtë e lehtë në meeting
12. Janë kabina detarësh
14. Një mund të jetë edhe fetar.
17. Emri i parë i Remarque.
18. Nuk tuten.
19. Rastet pa set.
20. Inicialet e Argento regjisor.
21. Janë dëshmi shoferësh.
22. Janë ufort.
23. Ishin fjalimet e Demostenit.
25. Eshhtë topi në rugby.
28. Ishin të oarët tanë.
30. Një vend nisjeje.
31. Lumë në Rusi.
33. Jepet për hartim.
36. Eshhtë elitë... e shoqërisë.
37. Mbreti i Cordelia-s.
39. Kufizojnë një studim.
40. Rifafrimuar pjesërisht
42. Botim pa kufij.
43. Mbetet në fund.
45. Fillojnë panikun



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
R	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N	T
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	T	H		
P	I	T	O	N	E	A	O	D	R	E	
A	C	T	O	N	E	K	A	L	M	A	S
K	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A	S
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P	
E	L	S	A	V	A	L	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T

**FJALËKRYQI (1)**

M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T	
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T	K	A	B	I	R	E	T	P
I	E	B	A	P	E	R	I	T	O	N	I
A	I	K	I	M	B	O	I	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	R	A	D	O	J	M	A
Y	M	A	R	S	I	A	N	E	T	J	A
M	A	J	A	F	O	R	M	A	T		
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T
A	S	I	T	R	A	D	A	M	E	S	T
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOK**

	2					1	3		
8				6				9	
			5			4			
6				8				1	
			4		5				
7				3					5
		8				4			
	9			2					8
1	3						6		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**


8	1	4	6	5	2	7	9	3	
9	2	3	7	4	8	6	1	5	
5	6	7	1	9	3	4	2	8	
3	7	1	5	6	9	8	4	2	
2	8	6	4	3	1	5	7	9	
4	9	5	2	8	7	3	6	1	
6	4	9	3	2	5	1	8	7	
7	5	2	8	1	6	9	3	4	
1	3	8	9	7	4	2	5	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Argëtim filozofik**

28. Me të njëjtën thjeshtësi që era çrrënjos një pemë të brishtë, tundimet tërheqin atë që është në kërkim të kënaqësive, që është i pangopur (lakmitar), dëmbel dhe i dobët. Por, si era që nuk mund të lëkundë një mal, asnjë tundim nuk lëkund të urtin, energjikun, të besueshmin që jeton thjesht.
29. Në këtë botë të gjithë do vdesim. Kujto, si mund të mbash armiqtësi?
24. Njeriu duhet të shpëtojë veten me përpjekjet e veta, asnjë nuk mund të bëjë për të, atë që ai duhet të bëjë për vete.

**KRIPTOSKEME**



**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



**Thënie të mënçura**

- "Fjalët e mira janë të shkurtëra dhe të lehta për t'u thënë, por jehona e tyre është vërtetë e pafundme". **Nënë Tereza**
- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjë në gjithçka! (**Giacomo Leopardi**)
- Ka dy lloj njerëzish në këtë botë: Ata që kanë diçka për të thënë, dhe ata që mbarojnë për të thënë diçka...
- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin.
- Nuk ka rëndësi kush të zhgënjëu, apo kush të rrëzoi, rëndësi ka kush të bëri të buzëqeshësh sërish.
- Mos ndiq askënd... një person që të vlerëson ecën përkrah teje.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al

## GAZETA SHQIPTARE

**KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA**

**Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon**

**Shëri për katshët, Raza Lali: Do t'i jap kustravece**

**Rezari Velezhija i "Portokallitë" ndahet nga e fejuara**

**VIP**

## Tashmë edhe lundroni!

**BLUE TOOTH**

**600 NËMRA, NJE HISTORI SURRESI**

**SUMMER**

**DORINA GEGICI**

**Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor**

**MUSIO**

**A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!**